# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5461
E enjte, 26 prill 2018
çmimi 0.40 €


## Merkeli: Shqipëria ka progres, për hapjen e negociatave vendosim më vonë

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP SELIMI FAQE 4-5

# Po manipulohet me ushtrinë e Kosovës



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, është shprehur i pakënaqur me ecurinë e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Ai ka thënë se që nga viti 2014, duke u nisur nga Qeveria Thaçi, Mustafa dhe tash kjo Haradinaj, kanë vazhduar të luajnë pingpong me FSK-në. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka thënë se që katër vjet vetëm është duke u manipuluar me formimin e ushtrisë së Kosovës. Madje, sipas tij, përderisa Lista Serbe është determinuese në Kuvend dhe Qeveri, Kosova nuk do të ketë ushtri. Selimi ka thënë se është optimizëm i rrejshëm që ushtria do të formohet së shpejti pasi, sipas tij, rrethanat politike dhe juridike nuk kanë ndryshuar. Deputeti Selimi ka paralajmëruar një dinamikë më të madhe të mbikëqyrjes parlamentare të Ligjit për FSK-në

INSTITUCIONET PUBLIKE NUK E RESPEKTOJNË KONTRATËN PËR SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE TË NËNSHKRUAR NDËRMJET MINISTRISË SË ADMINISTRATËS PUBLIKE (MAP) DHE TELEKOMIT TË KOSOVËS

# Institucionet nuk i blejnë shërbimet e Telekomit, por të privatëve



Derisa Telekomi i Kosovës po përballet me një krizë të thellë financiare, institucionet publike të Kosovës vazhdojnë t'i blejnë shërbimet telekomunikuese nga operatorët privatë dhe jo nga kjo kompani publike. Në këtë mënyrë institucionet nuk po e respektojnë kontratën kornizë të nënshkruar ndërmjet MAP-it dhe TK-së për ofrimin e të gjitha shërbimeve të telefonisë mobile, fikse dhe shërbimeve të rrjetit optik. Zyrtarët e Telekomit kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se zbatimi i kësaj kontrate do të ndikonte pozitivisht në performancën e përgjithshme të kësaj kompanie publike FAQE 3



# Partitë politike, pa konsensus për zgjedhje të parakohshme

Përfaqësuesit e subjekteve politike, në tryezën e thirrur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk kanë arritur ndonjë konsensus për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare FAQE 3

## AKTUALE

### ÇFARË ARSIMI NA DUHET?

F. 6



PROF. ASS. DR. RAGIP GJOSHI

### I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT AKTORIT ART KURTI

F. 6

### DEKADA E DYTË E SHTETIT KËRKON ANGAZHIMIN E TË GJITHËVE

F. 6



## EKONOMI

### KEDS-i: MOS BLINI NJEHSORË, SE JUA JAPIM FALAS

F. 9

### ASETET E SEKTORIT BANKAR ARRITËN VLERËN 3.88 MILIARDË EURO

F. 9

## KULTURË

### REPUBLIKA E SHQIPËRISË, 3 390 BURIME TURISTIKE

F. 13

## SPORT

### FETAHAJ: TITULLI DHE KUPA I TAKOJNË PRISHTINËS

F. 14

### SONTE GJYSMËFINALET E PARA NË EVROPA LIGË

F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është pritur të mërkurën në takim nga kancelarja gjermane Angela Merkel

# Merkeli: Shqipëria ka progres, për hapjen e negociatave vendosim më vonë

Kancelaria gjermane Angela Merkel ka thënë se Shqipëria ka bërë progres në shumë fusha, mirëpo Gjermania në ditët e ardhshme, bashkë me kolegët tanë evropianë, do të vendosë për çështjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkim Evropian



**Berlin, 25 prill** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në kuadër të vizitës zyrtare në Berlin, është pritur të mërkurën në takim nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel. Pas këtij takimi Rama dhe Merkeli kanë mbajtur një konferencë të përbashkët me gazetarë. Merkeli ka theksuar se Shqipëria ka bërë progres në shumë fusha, duke shtuar se Gjermania në ditët e ardhshme do të vendosë për çështjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkim Evropian (BE). "Ekzistojnë disa kushte për fillimin e negociatave të pranimit. Shqipëria ka punuar tashmë shumë për disa gjëra. Në ditët në vijim do ta krijojmë opinionin tonë përfundimtar, ndërsa do të diskutojmë edhe me kolegët tanë evropianë", ka thënë Merkeli.
Teksa e ka vlerësuar si tepër të rëndësishëm takimin me kryeministrin Rama, ajo ka thënë se Shqipëria ka bërë progres me reformën në drejtësi dhe se tashmë nevojitet një kontroll më i gjerë në polici. "Më lejoni të them në mënyrë eksplicite se Shqipëria ka nisur projekte të rëndësishme reformash dhe se është bërë përparim. Një prej tyre është vlerësimi i disa qindra gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo forcon sistemin ligjor në tërësinë dhe besueshmërinë e tij. Ne e dimë se tani kontrolli duhet të zgjerohet edhe në polici. Unë vetëm mund ta inkurajojë kryeministrin të vazhdojë në këtë rrugë me reforma", ka thënë Merkeli.
Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka falënderuar Merkelin për mbështetjen e dhënë për rajonin, në veçanti për shtetin shqiptar. Rama ka thënë se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave pas reformave të ndërmarra. "Falënderoj kancelaren Merkel për mbështetjen e saj ndaj Ballkanit Perëndimor në rrugën e integrimit evropian dhe në këtë kontekst, Shqipërinë. Falë vizionit të tyre dhe fuqisë së integrimit, procesi i Berlinit e ka transformuar rajonin. Ne kemi bërë përparime të pabesueshme. Kur u takuam në vitin 2014, folëm për të bërë një reformë themelore ligjore. Sot jam krenar të them këtu se Shqipëria ka kryer një reformë të thellë në fushën ligjore dhe gjyqësore, e cila është vlerësuar si e tillë nga Komisioni Evropian dhe si një model për të gjithë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor", ka thënë Rama.
Më tutje, kryeministri Rama ka theksuar se feja e shqiptarëve është Evropa. "Pas rekomandimit të Komisionit Evropian, unë shpresoj të kem mbështetjen e Gjermanisë dhe kancelares në qershor. Është shumë e qartë për ne se ky nuk është fundi. Ky është fundi i një faze dhe hapja e një faze tjetër. Ka shumë reforma, shumë sfida dhe shumë sakrifica që na presin. Kështu që, ne meritojmë të bëhemi anëtar i Bashkimit Evropian. Unë kam ardhur këtu për t'ia përcjellë kancelares besimin tim se Shqipëria nuk duhet të humbasë kohë në pritje të hapjes së negociatave për anëtarësim për shkak se Shqipëria e meriton atë. Shumica për Shqipërinë thotë se jemi myslimanë, por ne jemi një vend, ku të krishterët dhe myslimanët bashkëjetojnë me njëri-tjetrin. Nga veriu në jug i Shqipërisë, ata kanë të njëjtën fe. Kjo fe është Evropa", është shprehur Rama.
Rama gjatë vizitës zyrtare është takuar edhe me presidentin e Bundestagut gjerman, Wolfgang Schauble. Bundestagu gjerman në javët e ardhshme jep qëndrimin për rekomandimin e Komisionit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në.

# Bushati në OKB: T'i parandalojmë krizat




**Nju Jork, 25 prill** - Ministri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati, mori pjesë në takimin e nivelit të lartë për paqen, të organizuar nga Kombet e Bashkuara. Bushati e vuri theksin te pamjaftueshmëria dhe pamundësia për t'u përballur me nevojën urgjente të krizave, me të cilën po përballen shumë vende sot në botë. "Kompleksiteti i sfidave globale me të cilat përballemi tani kërkon qasje të reja të integruara për paqen, ide të reja dhe një menaxhim më efektiv të burimeve dhe mjeteve. Sipas mendimit tonë, parandalimi është fjala kyçe. Kombet e Bashkuara duhet të krijojnë mekanizma të aftë për t'i identifikuar shenjat e konfliktit të mundshëm, me qëllim që të veprojmë në kohë", tha Bushati.
Roli i OKB-së në këtë drejtim, sipas tij, është thelbësor. "Vendosja e parandalimit në zemër të punës së OKB-së kërkon bashkimin, në mënyrë koherente, të tri shtyllave të OKB-së: paqen dhe sigurinë, zhvillimin dhe çështjet e të drejtave të njeriut", tha kryediplomati shqiptar. Sa i takon Shqipërisë, Bushati deklaron se vendi mbetet i angazhuar dhe bindur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbështet pa rezerva platformat e OKB-së në këtë drejtim.

## Vuçiqi: Rruga jonë drejt BE-së varet nga Kosova



**Beograd, 25 prill** - Para nesh ndodhet një rrugë e gjatë deri në anëtarësimin e plotë në BE, por e tëra varet nga raportet me Kosovën, ndërsa të gjitha të tjerat shërbejnë si presion shtesë, tha të mërkurën presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq. Ai këto komente i bëri duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve në temën se ku ndodhet sot Serbia në rrugën e saj drejt BE-së. "Nga kjo varet e ardhmja jonë dhe kjo nuk do të thotë se duhet të japim gjithë ato që janë të nevojshme, pasi edhe pak nga kjo ka mbetur, por duhet të gjejmë zgjidhjen racionale dhe këtë çështje ta përmbyllim", tha Vuçiqi. Ai ditë më parë kishte deklaruar se Serbia dëshiron të bëhet vendi i parë i ardhshëm anëtar i BE-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Institucionet publike nuk e respektojnë kontratën për shërbimet telekomunikuese të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Telekomit të Kosovës

# Institucionet nuk i blejnë shërbimet e Telekomit, por të privatëve

Derisa Telekomi i Kosovës po përballet me krizë të thellë financiare, institucionet publike të Kosovës vazhdojnë t'i blejnë shërbimet telekomunikuese nga operatorët privatë dhe jo nga kjo kompani publike. Në këtë mënyrë institucionet nuk po e respektojnë kontratën kornizë të nënshkruar ndërmjet MAP-it dhe TK-së, për ofrimin e të gjitha shërbimeve të telefonisë mobile, fikse dhe të shërbimeve të rrjetit optik. Zyrtarët e Telekomit kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se zbatimi i kësaj kontrate do të ndikonte pozitivisht në performancën e përgjithshme të kësaj kompanie publike




EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 25 prill** - Institucionet e Republikës së Kosovës nuk po i blejnë për shfrytëzim shërbimet telekomunikuese të Telekomit të Kosovës, ndonëse për këtë ekziston një kontratë kornizë e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Telekomit të Kosovës. Kontrata publike kornizë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mes MAP-it dhe TK-së, e nënshkruar në fillim të vitit të kaluar, përfshin ofrimin e të gjitha shërbimeve të telefonisë mobile, fikse dhe shërbimet e rrjetit optik, për të gjitha institucionet publike lokale dhe qendrore. Pavarësisht prej obligimeve të kësaj kontrate, shumica e institucioneve të Kosovës nuk janë duke e respektuar atë dhe kanë zgjedhur që këto shërbime t'i blejnë nga kompanitë private.

Përfaqësuesit e Telekomit të Kosovës kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se shfrytëzimi i shërbimeve të Telekomit nga institucionet publike të Kosovës do ta ndihmonte shumë këtë kompani publike. "Shfrytëzimi dhe zbatimi i plotë i kësaj kontrate nga institucionet e Republikës së Kosovës (IRK) do të ndikonte pozitivisht në performancën e përgjithshme të Telekomit të Kosovës", ka thënë për gazetën "Epoka e re" Arsim Bilalli, zëdhënës i Telekomit të Kosovës.

Më tej, ai ka sqaruar se kjo kontratë ka filluar të zbatohet vetëm kohët e fundit. "Kontrata publike kornizë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese, e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Telekomit të Kosovës, veçanërisht në periudhën e fundit, është duke u shfrytëzuar nga institucionet e Republikës së Kosovës (IRK), me disa përjashtime. Natyrisht, mund dhe duhet të bëhet më shumë në këtë drejtim në mënyrë që të gjitha institucionet ta shfrytëzojnë këtë kontratë", është shprehur Bilalli.

Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike, Arton Berisha, ka deklaruar për "Epokën e re" se me nënshkrimin e kontratës janë njoftuar të gjitha institucionet e Kosovës. "Kontrata publike kornizë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mes MAP-it dhe Telekomit të Kosovës përfshin: 1. Të gjitha shërbimet e telefonisë mobile (shërbimet postpaid dhe shërbimet prepaid, komunikimi brenda grupit, mbushjet mujore në formë fizike, elektronike, GSM data si dhe Bulk-SMS); 2. Të gjitha shërbimet e telefonisë fikse (shërbimet e zërit dhe të kombinuara, shërbimet IP-TV shërbimet data-Internet dhe VPN ); dhe 3. Shërbimet e rrjetit optik (kablloja optike)", ka thënë Berisha.



Ai ka deklaruar se nuk mund t'i detyrojnë institucionet publike që ta respektojnë këtë kontratë. "Pasi që është nënshkruar kontrata ne i kemi njoftuar të gjitha institucionet qendrore dhe lokale. Ne nuk mund t'i obligojmë institucionet, sepse jemi në treg të lirë. Meqenëse Telekomi është ndërmarrje publike, mirë do të ishte që institucionet t'i shfrytëzojnë këto shërbime", është shprehur Berisha.

Kontrata të cilën e ka siguruar gazeta "Epoka e re" tregon se si institucionet publike të nivelit qendror dhe ato të nivelit lokal mund t'i shfrytëzojnë këto shërbime të Telekomit të Kosovës. "Lënda e kësaj kontrate krijon kushte për qasje të Ministrisë së Administratës Publike (MAP), si 'autoritet kontraktues', dhe institucioneve të Republikës së Kosovës (IRK) 'Autoritetet kontraktuese' në shërbimet telekomunikuese të ofruara nga Telekomi i Kosovës Sh. A., si 'Ofrues i shërbimeve'. Këto shërbime mundësojnë qasje në produktet dhe shërbimet e telefonisë mobile dhe të telefonisë fikse (pako të zërit-TiKtel, pako Data-TiKon, pako të internetit Wirless, Hot-Spot - TiKon@Pika, pakot mediatike-TiKtv, pako të kombinuara -Tv, zë dhe data, linja ISDN, SIP linjat telefonike, linjat Centrex, shërbimin 0800, internetin e dedikuar ProOn, VPM, linjat e huazuara kombëtare, WEB shërbimet dhe kablloja optike)", thuhet në nenin e parë të kësaj kontrate.

Po në këtë nen tregohet edhe procedura se si duhet të bëhet pagesa për këto shërbime. "Kjo kontratë do të shfrytëzohet nga MAP-i dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Kërkesa për shfrytëzimin e kësaj kontrate nga IRK-të bëhet zyrtarisht përmes MAP-it, ndërsa faturimi dhe pagesa e faturave të krijuara në baza mujore bëhet nga IRK-të veç e veç, duke u bazuar në produktet dhe shërbimet e përzgjedhura. Kontrata publike kornizë do të implementohet me 'vendosjen e porosive' apo thirrjet'", thuhet në këtë nen.

Në fillim të kësaj jave kryesuesja e Bordit të Telekomit të Kosovës, Besa Shatri-Berisha, ka bërë me dije se kjo ndërmarrje publike është duke u përballur me humbje të mëdha financiare. Në raportimin e saj para kabinetit qeveritar, Shatri-Berisha ka thënë se vetëm në tremujorin e parë të këtij viti kjo ndërmarrje ka pësuar humbje prej katër milionë eurosh. "Telekomi aktualisht gjendet në një krizë të thellë financiare. Borxhet e njohura të kompanisë janë mbi 60 milionë euro, prej tyre 11 milionë janë vetëm furnitorë të rregullt, përderisa humbja për tre muajt e parë është mbi katër milionë euro. Të hyrat vazhdojnë të bien, ndërsa shpenzimet janë në rritje. Pasuria neto e kompanisë aktualisht është 34 milionë euro, ndërsa likuiditeti i cili e rrezikon më së shumti kompaninë është 0.3 %, që nënkupton se nga 60 milionë euro borxhe sa i kemi, jemi në gjendje t'i paguajmë vetëm 18 milionë", ka thënë Berisha-Shatri.

## I jepet lamtumira e fundit aktorit Art Kurti



**Gjakovë, 25 prill** - Në varrezat e Tyrbes "Sheh Fetahu" i është dhënë të mërkurën lamtumira e fundit aktorit 23-vjeçar, Art Kurtit, i cili u gjet i vdekur një ditë më parë në një veturë, në fshatin Goden të Gjakovës.

Dyshimet e para, sipas raporteve të policisë, çojnë në aktin e vetëvrasjes.

Për ta nderuar veprimtarinë e Art Kurtit në Sallën e Kulturës në Gjakovë është mbajtur një mbledhje komemorative. Motra e Art Kurtit, Mirjeta, ka ndarë dhimbjen e saj me të pranishmit, ndërsa dhe ka ndjerë keqardhje që nuk arriti të bënte më shumë për mbrojtjen e vëllait.

Flet për "Epokën e re", Rexhep Selimi

# Po manipulohet me

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, është shprehur i pakënaqur me ecurinë e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Ai ka thënë se që nga viti 2014, duke u nisur nga Qeveria Thaçi, Mustafa dhe tash kjo Haradinaj, kanë vazhduar të luajnë pingpong me FSK-në. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka thënë se që katër vjet vetëm është duke u manipuluar me formimin e ushtrisë së Kosovës. Madje, sipas tij, përderisa Lista Serbe është determinuese në Kuvend dhe Qeveri, Kosova nuk do të ketë ushtri. Selimi ka thënë se është optimizëm i rrejshëm që ushtria do të formohet së shpejti pasi, sipas tij, rrethanat politike dhe juridike nuk kanë ndryshuar. Deputeti Selimi ka paralajmëruar një dinamike më të madhe të mbikëqyrjes parlamentare të Ligjit për FSK-në



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 25 prill - Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se prej vitit 2014 është duke u manipuluar me ushtrinë e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se përderisa Lista Serbe është determinuese në Kuvend dhe Qeveri, Kosova nuk do të ketë ushtri. Selimi ka paralajmëruar një mbikëqyrje më dinamike ndaj Ligjit për FSK-në, duke thënë se konstatimi i Raportit të Progresit ka qenë me vend meqë nuk ka pasur mbikëqyrje të mjaftueshme për FSK-në. Ai ka folur edhe për mbikëqyrjen parlamentare për Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin, me ç'rast ka bërë me dije se kanë hasur në probleme shumë të mëdha. "Pas një dinamike shumë të madhe si komision do të dalim me rekomandime për seancë plenare. Problemet janë shumë më të mëdha brenda këtyre institucioneve sesa ne kemi mundur ta kemi një perceptim nga jashtë. Pra, si rezultat i mbikëqyrjes sonë kemi arritur t'i identifikojmë shumë probleme. Në bazë të kompetencave dhe mandatit si deputetë ne do t'i drejtohemi me rekomandime seancës plenare, por nuk është çudi t'i drejtohemi edhe prokurorisë nëse hasim në diçka që është lëndë për prokurorinë", është shprehur Selimi, duke shtuar se rekomandimet mund të mos zbatohen nëse i referohemi së kaluarës. Ai ka thënë se sigurinë në Kosovë dhe në rajon vazhdon ta kërcënojë qasja e Serbisë karshi fqinjëve. "Sfida kryesore për sigurinë në vend mbetet qasja dhe politika e Serbisë të cilat nuk dallojnë nga sistemi i Millosheviqit. Serbia nuk na kërcënon vetëm nga jashtë, pra nga Beogradi, por na kërcënon edhe nga Mitrovica, edhe nga Prishtina dhe, jo rrallëherë, edhe nga Kuvendi i Kosovës përmes Listës Serbe", është shprehur Selimi.

**"Epoka e re":** *Z. Selimi, Raporti i Progresit ka pasur vërejtje për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe për këtë ka kritikuar Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë. Pse po mungon mbikëqyrja parlamentare për FSK-në?*

**Selimi:** Është e vërtetë se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë nuk ka mbikëqyrur mjaftueshëm FSK-në, pra aq sa ka mbikëqyrur institucionet e tjera të sigurisë. Kjo nuk ka ndodhur as për fajin e komisionit e as të FSK-së, por për shkak se mbikëqyrjet në Policinë e Kosovës dhe në Inspektorat të Policisë kanë qenë si pasojë jo rrallëherë e skandaleve. Kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet ta mbikëqyrim edhe më shumë FSK-në, madje ka ndodhur mbikëqyrje e herëpashershme nëse u referohemi dëgjimeve të komandantit të FSK-së, të ministrit të FSK-së si dhe vizitave. Megjithatë, është e vërtetë se grup punues për mbikëqyrjen e FSK-së nuk ka pasur në legjislaturën e kaluar. Në mbledhjen e së martës të komisionit kemi shqyrtuar Raportin e Progresit dhe kemi konstatuar se me të drejtë ky raport ka thënë se nuk ka pasur mbikëqyrje të FSK-së. Prandaj, kemi ndërmarrë hapat e menjëhershëm për të formuar grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për FSK-në. Besoj se brenda sesionit pranveror do të kemi një mbikëqyrje të Ligjit për FSK-në.

**"Epoka e re":** *Tash e tutje do të ketë dinamikë më të madhe të mbikëqyrjes?*

**Selimi:** Mbikëqyrjen e FSK-së e kemi në planin e veprimit të komisionit për këtë vit. Krejt çfarë mund të ndodhë është shpejtimi i dinamikës së mbikëqyrjes. Konstatimi i Raportit të Progresit ka qenë me vend sepse nuk ka pasur për një kohë të gjatë grupe mbikëqyrëse të zbatimit Ligjit për FSK-në.

**"Epoka e re":** *Si është gjendja e mbikëqyrjes parlamentare tek institucionet e tjera të sigurisë?*

**Selimi:** Aktualisht jemi në dinamikën më të lartë të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës. Këtë mbikëqyrje jemi duke e bërë me shkas, pra si pasojë e skandaleve që kanë plasur në Policinë e Kosovës dhe në Inspektoratin e Policisë. Po mbikëqyrim ngjarjet që kanë ndodhur referuar policisë dhe inspektoratit, respektivisht skandalit të procesit të rekrutimit të një konkursi në Inspektorat, përfshirjes së zyrtarëve policorë në rrahje në Prishtinë, po ashtu edhe bashkëveprimit të policisë, inspektoratit dhe prokurorisë me këto raste.

**"Epoka e re":** Cilat janë rezultatet e arritura në këtë drejtim?

**Selimi:** Është herët të flasim për rezultate, por mund të them se atje kemi hasur në probleme shumë më të mëdha sesa kemi menduar paraprakisht. Rezultatet apo gjetjet nuk mund t'i ndajmë me mediet pa e përfunduar procesin e mbikëqyrjes. Deri më tani i kemi thirrur në dëgjim 13 zyrtarë të Inspektoratit dhe në ditët në vijim do të thirren së paku edhe pesë zyrtarë të tjerë. Do t'i konsultojmë edhe institucionet ndërkombëtare që kanë mbështetur Inspektoratin deri më tash dhe organizatat e tjera joqeveritare. Pas një dinamike shumë të madhe si komision do të dalim me rekomandime për seancë plenare. Problemet janë shumë më të mëdha brenda këtyre institucioneve sesa ne kemi mundur ta kemi një perceptim nga jashtë. Pra, si rezultat i mbikëqyrjes sonë kemi arritur t'i identifikojmë shumë probleme. Në bazë të kompetencave dhe mandatit si deputetë ne do t'i drejtohe-

# ushtrinë e Kosovës



mi me rekomandime seancës plenare, por nuk është çudi që t'i drejtohemi edhe prokurorisë nëse hasim në diçka që është lëndë për prokurorinë.

**"Epoka e re":** *Mund të ketë punë edhe prokuroria në këtë proces?*
**Selimi:** Atë çfarë po shohim dhe po gjejmë atje, duket nuk do të ketë punë vetëm shqyrtimi i seancës plenare, por edhe prokuroria.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej këtyre skandaleve, Policia e Kosovës dhe FSK-ja vazhdojnë të jenë institucionet më të besueshme nga qytetarët.*
**Selimi:** Policia e Kosovës dhe FSK-ja ende janë institucionet më kredibile në shoqëri. Kur flasim për problemet brenda këtyre dy institucioneve duhet bërë ndarja në mes të institucioneve dhe atyre që punojnë me përkushtim, në anën tjetër atë të disa zyrtarëve të cilët me veprime të lokalizuara kanë bërë që të lëndohen kredibiliteti dhe besueshmëria e institucioneve. Pra, kur të flasim për problemet dhe për individë të caktuar, nuk flasim për të gjithë ata policë e ushtarë të cilët po vazhdojnë të punojnë me përkushtim. FSK-ja dhe Policia e Kosovës nuk janë sikur ata që rrahin rrugëve zyrtarë të postës apo sikur ata që intervenojnë për konkurs. Policët dhe ushtarët e Kosovës janë njerëz të përkushtuar dhe këtu bëjnë pjesë shumica. Ne kemi arritur ta ndajmë me një vijë të dukshme institucionin prej problemeve që kanë krijuar disa zyrtarë.

**"Epoka e re":** *Rritja e mbikëqyrjes parlamentare do të ndikojë në zvogëlimin e problemeve?*
**Selimi:** Pas kësaj mbikëqyrje nuk pres të kemi probleme dhe ngecje në rrugën tonë parlamentare deri në votimin e rekomandimeve. Një hallkë ka pasur probleme gjithmonë në rrugën e mbikëqyrjes. Është hallka e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet ligjzbatuese. Në të kaluarën ka pasur mbikëqyrje dhe Kuvendi ka miratuar rekomandimet e grupit punues, respektivisht komisionit, por ato nuk janë zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**"Epoka e re":** *Ka rrezik që edhe tash rekomandimet të mos zbatohen?*
**Selimi:** Nëse i referohemi së kaluarës kemi drojë se mund të mos zbatohen. Shumë prej rekomandimeve nuk janë zbatuar as sot e kësaj dite, ndonëse ato janë dhënë para pesë vjetëve në një seancë ku janë miratuar me përkrahjen e të gjitha grupeve parlamentare.

**"Epoka e re":** *Z. Selimi, si e komentoni procesin e transformimit të FSK-së?*
**Selimi:** Në Kuvendin e Kosovës që katër vjet kanë ardhur rekomandimet apo propozim-amendamentet kushtetuese për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovë në Forcë të Armatosur të Kosovës. Që nga viti 2014 qeveritë, herë e Thaçit, herë e Mustafës, tashti e Haradinajt, po vazhdojnë të luajnë pingpong me FSK-në. Kështu, prej vitit 2014 vetëm se është manipuluar me ushtrinë e Kosovës. Është luajtur me diçka që nuk duhet të luhet, me sigurinë e vendit. Kështu që, propozimet e tanishme për ndryshime ligjore kemi të drejtë t'i shohim me skepticizëm dhe dyshim referuar së kaluarës, kur qeveritë, njëra pas tjetrës, kanë vazhduar të manipulojnë me këtë çështje shumë të rëndësishme për Kosovën.

**"Epoka e re":** *Mund të zvarritet edhe më tutje ky proces, ndonëse liderët shtetërorë në vazhdimësi po thonë se transformimi i FSK-së do të ndodhë shpejt?*
**Selimi:** Nuk do të ndodhë shumë shpejt. Edhe pse do të dëshiroja që ky proces të përfundojë shpejt, sepse në vazhdimësi u kemi dhënë përkrahje avancimeve ose rritjes së kapaciteteve ushtarake të Kosovës. Nuk kam besim se do të ndodhë meqë janë të njëjtat rrethana juridike dhe politike në Kosovë sikurse që kanë qenë para katër vjetësh. Nuk kanë ndryshuar këto rrethana në mënyrë që të kemi mundësi të bëjmë diçka. Aq më tepër nuk ka ndryshuar as vullneti i atyre që e përcaktojnë fatin e ushtrisë së Kosovës siç është Lista Serbe. Përderisa kemi Listën Serbe determinuese në Kuvend dhe Qeveri, Kosova nuk do të ketë ushtri. Ne e dimë se si do të vendosë Lista Serbe kur bëhet fjalë për shtetin, ushtrinë dhe sigurinë e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Por liderët po shprehin optimizëm.*
**Selimi:** Është optimizëm i rrejshëm sepse rrethanat dhe kushtet janë të njëjta siç kanë qenë edhe në të kaluarën.

**"Epoka e re":** *Cilat mendoni se janë sfida kryesore në fushën e sigurisë së Kosovës?*
**Selimi:** Siguria në Kosovë dhe në rajon vazhdon ta kërcënojë qasja e Serbisë karshi fqinjëve. Pa një qasje të tillë të Serbisë në rajon do të kishte më shumë qetësi dhe më shumë paqe. Sfida kryesore për sigurinë në vend mbetet qasja dhe politika e Serbisë të cilat nuk dallojnë nga sistemi i Milloshevigit. Natyrisht se Kosova nuk është imune as ndaj problemeve të tjera globale siç është terrorizimi apo të tjera. Mirëpo problemi kryesor i sigurisë mbetet qasja e Serbisë ndaj Kosovës dhe mekanizmat e saj në vendin tonë. Serbia nuk na kërcënon vetëm nga jashtë, pra nga Beogradi, por na kërcënon edhe nga Mitrovica, edhe nga Prishtina dhe, jo rrallëherë, edhe nga Kuvendi i Kosovës përmes Listës Serbe.

## Hoxhaj: Ulësja në OKB dhe Asociacioni, në të njëjtën kohë

**Prishtinë, 25 prill -** Krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të bëhet paralelisht me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, thotë zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj. Sipas tij, Kosova nuk duhet të nxitohet ta formojë këtë mekanizëm dhe ai duhet të bëhet funksional vetëm atëherë kur vendi ta ketë marrë ulësen e tij si anëtar me të drejta të plota në OKB. "Meqë Asociacioni synon ta avancojë pozitën e serbëve në Kosovë, unë jam i mendimit se themelimi i tij de fakto duhet të ndodhë paralelisht me anëtarësimin e Kosovës në OKB, kur Kosova ta marrë një status juridik dhe njohje ndërkombëtare të plotë", ka thënë Hoxhaj për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka shtuar se nuk është me rëndësi se çështja e Asociacionit a do të futet në një pako të një marrëveshje finale të dialogut me Serbinë por ajo, sipas tij, duhet të ecë si një proces paralel. "E rëndësishme është që duhet të jetë pjesë e një procesi të njëjtë dhe mendoj se e përmbush edhe pritjen që kanë qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë, por e përmbush edhe pritjen që ka Kosova si tërësi dhe partnerët perëndimorë të Kosovës si mbështetës të saj", ka thënë Hoxhaj.



# Në dekadën e dytë e shtetit kërkohet angazhimi i të gjithëve

Dekada e dytë duhet ta gjejë Kosovën të integruar në Bashkimin Evropian, të anëtarësuar në NATO, pjesë të OKB-së, si dhe me proces të përmbyllur të dialogut me Serbinë. Kështu është thënë të mërkurën nga përfaqësuesit e shtetit dhe të partive politike, në konferencën me temë "Dekada e ardhshme e Kosovës: avancimi i reformave, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian", e cila është organizuar nga Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan. Për të gjitha këto tema është kërkuar konsensus i domosdoshëm politik



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 25 prill** - Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të mërkurën në konferencën me temë "Dekada e ardhshme e Kosovës: avancimi i reformave, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian", e cila është organizuar nga Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan.

Në këtë konferencë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të partive politike.

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se kjo konferencë dhe nismat e ngjashme janë shumë të rëndësishme për të sotmen por, para së gjithash, edhe për të ardhmen e Kosovës, me reflektime edhe për rajonin. "Për bindjen time, në politikën e Kosovës ka një pjekuri politike, në të njëjtën kohë, si në tërë rajonin, kjo politikë përcillet edhe me thashetheme, me spekulime dhe me pak debate me argumente e kundërargumente dhe mendime e diskutime të mirëfillta se ku jemi si politikë, ku jemi si institucione, ku jemi si shoqëri civile dhe ku janë edhe mediet e Kosovës", ka thënë Thaçi, duke shtuar se duhet shtruar pyetjen se çfarë tash e tutje për ta avancuar në mënyrë thelbësore agjendën e shtetit të Kosovës, reformimin e plotë të shoqërisë në vitet dhe dekadat e ardhshme. Kreu i shtetit është shprehur besimplotë se javët dhe muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë për shumë aspekte, përfshirë edhe konsolidimin dhe forcimin e shtetit të Kosovës. "Ajo çfarë neve na mungon është debati i mirëfilltë. Nuk duhet të mos fokusohemi vetëm në politikën ditore apo në politikat e javës së ardhshme, por në një politikë sa më konsensuale, transparente, të agjendës së qartë institucionale edhe përbrenda, por edhe në raport me rajonin dhe botën perëndimore. Natyrisht, edhe në raport me vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës", ka thënë ai.

Presidenti ka thënë se Kosova është storie e suksesit të plotë, porse jemi dëshmitarë se në vitet e fundit institucionet e vendit kanë funksionuar me një brishtësi më të madhe. "Si rezultat i kësaj kemi pasur edhe zhvillimet në Kuvendin e Kosovës, zhvillimet e panevojshme që kanë dërguar një mesazh dhe pamje jo të realitetit të Kosovës, por një pamje vizuale aspak të pëlqyeshme për vendin tonë në botë. Ato kanë arritur ta dobësojnë edhe pozicionin e vendeve mbështetëse për Kosovën dhe të prodhojnë argumente për ata që ende kanë hezitime për njohjen e pavarësisë apo që janë kundër pavarësisë së Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit ka thënë se të gjitha këto janë tejkaluar me pjekuri politike. "Tani kemi të votuar me dy të tretat demarkacionin me Malin e Zi dhe kemi filluar punën për funksionalizimin e ekipit menaxherial për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë Thaçi.

Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli, duke folur në këtë në konferencë, ka theksuar se Dekada e re e Pavarësisë duhet të jetë dekadë e punëve të mëdha të përbashkëta. "Është dekadë e shpresës, e nevojës për transformim të shpejtë ekonomik dhe për fuqizim të shtetit. Është dekadë, në të cilën, secili dhe të gjithë, duhet të kemi më shumë besim dhe përkushtim për shtetin tonë të pavarur dhe sovran", ka deklaruar Veseli.

Po në këtë konferencë ka folur edhe kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se si pikënisje, në fund të këtij viti Kosova fiton liberalizimin e vizave. "Në agjendë kemi aplikimin për statusin e vendit kandidat në BE, transformimin e FSK-së në ushtri dhe po punojmë çdo ditë për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe zhvillimin ekonomik. Dekada jonë e dytë duhet të na gjejë të integruar në Bashkimin Evropian, të anëtarësuar në NATO, pjesë e OKB-së, me proces të përmbyllur me Serbinë, dhe për këto konsensusi politik është i domosdoshëm", ka thënë Haradinaj.

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se mungesa e stabilitetit politik i ka shkaktuar shumë probleme Kosovës në dekadën e parë të saj si shtet. Haziri ka thënë se dekada e parë e shtetësisë ka qenë një mundësi e humbur.

Në konferencën "Dekada e ardhshme e Kosovës: avancimi i reformave, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian", përfaqësuesi i Grupit të Deputetëve të Pavarur, Visar Ymeri, ka thënë se duhet ta diskutojnë, ndryshojnë, reformojnë dhe dinamizojnë shoqërinë tonë.

# Qeveria japoneze ndihmon ShSKUK-në me një milion euro

Qeveria japoneze në kuadër të marrëveshjes që ka nënshkruar me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) do t'i ndihmojë me një donacion klinikat e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) në vlerë prej 1.1 milion eurosh për pajisje të ndryshme mjekësore



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 25 prill** - Ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqi, i shoqëruar nga zyrtarë të MSh-së, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë zhvilluar të mërkurën takimin e parë të Komitetit Drejtues për zbatimin e grantit japonez për sigurimin e pajisjeve për ShSKUK-së, me përfaqësues të Japonisë.

Takimi është realizuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës dhe Qeverisë Japoneze. Sekretari Bardiqi është shprehur falënderues për mbështetjen e vazhdueshme që populli japonez po i jep Kosovës, në çdo fushë, në veçanti në sektorin e shëndetësisë. Ai ka theksuar se mbështetja e Qeverisë Japoneze përmes marrëveshjes së bashkëpunimit do t'i zbusë ndjeshëm nevojat e ShSKUK-së për pajisje mjekësore respektivisht do ta ndikojë lehtësimin e punës së profesionistëve shëndetësorë dhe sigurisht do të reflektojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në klinikat e saj.

Përfaqësuesi i Ambasadës së Japonisë në Vjenë, Mitsunori Ogasawara, shpreson se kjo ndihmë do të ndikojë sadopak në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, duke theksuar se kjo nuk është ndihma e parë, por as nuk do të jetë e fundit që ata ofrojnë për qytetarët e Kosovës.

Marrëveshja parasheh një donacion për klinikat e ShSKUK-së, në vlerë prej 1.1 milion eurosh, për pajisje të ndryshme mjekësore, që do të realizohet në vitin 2019. Nga ky donacion do të përfitojnë Klinika e Neurologjisë, ku do të pajiset me CT -16 shtresore dhe një ultrazë dopler për ekzaminime neurologjike, Klinika e Gastroenterolgjisë do të përfitojë nga ky donacion një aparat për gastroskopi dhe kolonoskopi, Klinika Infektive do të përfitojë një röntgen digjital, Klinika e Urologjisë do të pajiset me urotroskop fleksibil, Klinika e Kirurgjisë Vaskulare do të pajiset me ultrazë dopler dhe Klinika e Pulmologjisë do të pajiset me një bronkoskop.

Mbahet konferenca e thirrur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për situatën e krijuar politike në vend

# Partitë politike, pa konsensus për zgjedhje të parakohshme

**Përfaqësuesit e subjekteve politike, në tryezën e thirrur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk kanë arritur ndonjë konsensus për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Pas përfundimit të këtij takimi, përfaqësuesit e subjekteve politike kanë thënë se janë pajtuar të vazhdohet organizimi i takimeve të tilla edhe në ditët e ardhshme**



LDK (Courtesy Photo)

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 25 PRILL - Të gjitha subjektet politike parlamentare, me përjashtim të Listës Serbe, i janë përgjigjur të mërkurën pozitivisht ftesës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për tryezën e përbashkët për ta shqyrtuar gjendjen politike në vend. Pas takimit, i cili ka qenë i mbyllur për mediet, zyrtarët e subjekteve politike kanë bërë me dije se janë pajtuar për të vazhduar me tryeza të tilla edhe në ditët e ardhshme. Ndonëse fillimisht ishte paralajmëruar se në takim do të diskutohet për caktimin e datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vend, përfaqësuesi i partisë politike, Agim Veliu, nënkryetar i Lidhjes Demokratike e Kosovës, ka theksuar se takimi nuk është ftuar të diskutohet për zgjedhje të parakohshme, por për të diskutuar me subjektet politike dhe të bëhet përpjekje që të gjenden zgjidhjet për çështjet që janë me interes për Kosovën. "Ne jemi të interesuar që çështjet madhore për Kosovën t'i diskutojmë dhe së bashku të gjejmë zgjidhje. Ne po bëjmë përpjekje ta japim kontributin tonë, që ta arrijmë një konsensus nacional për këto tema dhe pastaj, nëse nuk arrihet, ne sigurisht se do ta diskutojmë në forumet tona dhe do të marrim qëndrim", ka thënë Veliu.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se është rastësi që temat e diskutuar në këtë tryezë të kenë ngjashmëri me ftesën që ka bërë ditë më parë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, për një platformë gjithëpërfshirëse. "Pajtohemi se duhet të këtë një pjesëmarrje, një gjithëpërfshirje, një konsensus të partive politike, të spektrit më të gjerë politik, në mënyrë që t'i kalojmë ato në një mënyrë më të shpejtë dhe më të lehtë. Veçanërisht, ato që ndërlidhen me temat siç janë: themelimi i ushtrisë, procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, procesi i reformës së përgjithshme në kuadër të integrimit evropian, si dhe reforma zgjedhore", tha Krasniqi.

Sekretari i përgjithshëm i AAK-së, njëherësh deputet, Blerim Kuçi, ka thënë se në këtë takim janë iniciuar diskutimet për temat, për të cilat në vazhdimësi është thënë se nevojitet konsensusi. "Jemi marrë vesh vetëm për dy çështje: që të vazhdojmë, si dhe jemi marrë vesh që para jush të themi se çdo subjekt politik ka shfaqur mendimet e veta rreth këtyre temave. Të gjitha elementet e tjera janë qëndrime partiake, por jo të kësaj tryeze këtu. Ju e dini se Qeveria po funksionon. I ka apo si ka numrat, ajo po funksionon", ka thënë Kuçi.

Pas këtij takimi ka folur edhe shefi i grupit të Deputetëve të Pavarur, Dardan Sejdiu, i cili ka thënë se përfaqësuesit e secilit subjekt politik kanë shpërfaqur qëndrimet mbi temat, të cilat konsiderohen të mëdha.

Ndërkaq shef i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se në këtë takim ka shfaqur mendimin e kësaj partie për temat për të cilat kanë konsideruar se janë me interes për vendin. Ai ka pohuar se Nisma nuk mendon se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. "Konsiderojmë se Qeveria sapo ka filluar punën dhe duhet t'i lihet kohë dhe hapësirë që ta vazhdojë punën e vet", ka thënë Sherifi.

Kurse deputeti Ilir Deda nga Alternativa ka pohuar se takimi i partive politike është vetëm një nismë për të parë se a mund të ketë konsensus ndërmjet tyre për temat e mëdha. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe disa subjekte politike joparlamentare.

# KDI-ja: Kosova ta kërkojë kthimin e pensioneve nga Serbia




PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ka organizuar të mërkurën tryezën "Statusi i fondit pensional të Kosovës në kontekstin e dialogut Kosovë - Serbi", një diskutim me deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të akademisë, shoqërisë civile dhe medias.

Në hapje të tryezës, Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka theksuar se ky institucion ka punuar gjatë dy vjetëve të fundit me Kuvendin e Kosovës për ta fuqizuar rolin e saj mbikëqyrës ndaj ekzekutivit në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, ku ka punuar për së afërmi me komisionet parlamentare për t'i ngritur dhe trajtuar çështjet e rëndësishme në dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë kontekst, KDI-ja me Komisionin ka iniciuar realizimin e një hulumtimi rreth fondit pensional të Kosovës në kontekstin e bisedimeve Kosovë - Serbi.

Ndërkaq Artan Mustafa, autor i hulumtimit, ka theksuar se hulumtimi trajton organizimin e politikave pensionale në ish-Jugosllavi, obligimet e marra nga shtetet që kanë dalë nga Federata Jugosllave, si dhe ofron modalitetet e mundshme për zgjidhjen e kësaj çështje nga Republika e Kosovës si pjesë e marrëveshjes së suksesionit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, Mustafa ka vlerësuar se reforma pensionale duhet ta synojë krijimin e një sistemi të unisuar në tërë Republikën e Kosovës duke u bazuar në sistemin e solidaritetit të njohur si 'Pay-as-you-go', që do ta nxisë interesin e komunitetit serb të bëhet pjesë e sistemit.

Në këtë diskutim u theksua se çështja e pensioneve nuk është adresuar asnjëherë në mënyrë serioze në dialogun e Brukselit dhe u kërkua që ky problem të trajtohet në mënyrë urgjent dhe me prioritet në dialog.

# Kanadezët të interesuar për investime në sektorin e minierave



PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, ka pritur të mërkurën një delegacion të Korporatës Minerare "Trevali" nga Kanadaja, të drejtuar nga presidenti dhe kryeshefi ekzekutiv i saj, Mark D. Cruise, e cila është e specializuar në sektorin e minierave, në veçanti atë të zinkut.
Ministri Lluka ka njoftuar Cruise me resurset minerare që ka Kosova dhe mundësitë për investime në këtë sektor, duke theksuar angazhimin e Qeverisë për të krijuar një mjedis sa më të favorshëm për investimet e jashtme.
Ndërsa Cruise ka prezantuar aktivitetet momentale të kompanisë që drejton në Kanada dhe Afrikë, ndërsa ka shprehur interesimin për sektorin e minierave të Kosovës. Cruise ka bërë me dije se nga prezantimet të cilat i ka parë në Konventën e PDAC në Toronto të Kanadasë ku ishte i pranishëm edhe ministri Lluka kanë ngjallur interesimin e tij për këtë sektor në Kosovë. Ai ka theksuar se Korporata Minerare "Trevali" është prodhuesja e tetë më e madhe në botë e zinkut. Cruise ka treguar se Korporata Minerare "Trevali" është e specializuar në minierat e vjetra, të cilat i kanë revitalizuar dhe i kanë bërë ekonomikisht të leverdishme.

# KEDS-i: Mos blini njehsorë, se jua japim falas

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) ka njoftuar të gjithë konsumatorët e vet se, me rastin e lidhjeve të reja, atyre u shpërndahen njehsorët elektrikë falas. Sipas KEDS-it, asnjë konsumator nuk ka nevojë ta blejë atë dhe as ta montojë pasi këtë e bën KEDS-i.
"Instalimi i njehsorëve bëhet nga ekipet e specializuara të KEDS-it. Prandaj, KEDS-i apelon t'i shmangni individët joprofesionalë dhe pa specializime përkatëse për vendosjen e tyre. Me Ligjin për Furnizim me Energji Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në këtë rast KEDS-i, është pronar dhe përgjegjës i aseteve deri tek pika përfundimtare matëse", është thënë në njoftimin e KEDS-it.
KEDS-i ka theksuar se për t'u mos krijuar shpenzime të dyfishta, të gjithë konsumatorët që e kanë përfunduar ndonjë objekt banimi apo kanë filluar ndonjë aktivitet apo biznes, dhe u nevojitet lidhje e re, ata duhet të bëjnë kërkesë në KEDS për njehsorë. "Kompania në kohën më të shkurtër të mundshme do t'i pajisë ata me njehsorë, të cilët janë në pajtim të plotë me ligjet e shtetit të Kosovës dhe në përputhje me normat dhe standardet më të larta ndërkombëtare", është thënë në njoftimin e KEDS-it.
Ky institucion ka njoftuar se në vazhdimësi ka bërë ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes investimeve të vazhdueshme në rrjet që nga nisja e operimeve, pesë vjet më parë. "Nga këto shërbime kanë përfituar dhjetëra mijë konsumatorë anekënd vendit. KEDS-i është duke i vazhduar investimet, madje edhe më fuqishëm, në mënyrë që rrjeti të ofrojë shërbime sa më kualitative dhe sa më të sigurta për të gjithë qytetarët e Kosovës", thuhet në njoftimin e KEDS-it.



# Asetet e sektorit bankar arritën vlerën 3.88 miliardë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 PRILL - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar raportin për vlerësimin e tremujorit të katërt (TM4) të vitit 2017. Sipas këtij raporti, sektori bankar vazhdon të ketë rritje të përshpejtuar të aktiviteteve kredituese. Po sipas këtij raporti, asetet e sektorit bankar në TM4 - 2017 u zgjeruan për 66.1 milionë euro, duke arritur vlerën prej 3.88 miliardë eurosh. "Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues, performancë të mirë financiare dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit. Asetet e sektorit bankar në TM4 2017 u zgjeruan për 66.1 milionë euro, duke arritur vlerën prej 3.88 miliardë eurosh. Kontributin kryesor në zgjerimin e aseteve të sektorit bankar për të dytin vit me radhë vazhdon ta ketë aktiviteti kreditues", është thënë në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, investimet në letrat me vlerë kishin kontributin e dytë më të rëndësishëm në rritjen e gjithsej aseteve të sektorit në TM4 - 2017. Ndërkaq, sa iu përket kredive të lëshuara nga sektori bankar, sipas këtij raporti, kreditë kishin shënuar rritje në periudhën paraprake.

Sektori bankar ka kredituar ekonominë vendore në vlerë rekorde prej 78.2 milionë eurosh në TM4 - 2017, dukshëm më e lartë se vlera prej 45.6 milionësh e shënuar në TM4 - 2016, duke arritur vlerën prej 2.49 miliardë eurosh. Ndikim në rritjen e kredive aktive kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet (të cilat u rritën për 65.9 milionë euro në baza vjetore në TM4 - 2017 dhe arritën vlerën prej 218.3 milionë eurosh) dhe ekonomitë familjare (të cilat u rritën për 46 milionë euro në TM4 - 2017 dhe arritën në 143.9 milionë euro)", është thënë në raportin e BQK-së.

Në këtë raport të BQK-së është bërë me dije se zhvillimet në stokun e kredive aktive dhe atyre të reja u ndikuan nga oferta lehtësuese e aplikuar nga bankat përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë ekonomike. Sipas këtij raporti, kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM4 - 2017 u rritën për 55.2 milionë euro dhe arritën vlerën prej 1.58 miliard eurosh. "Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i tregtisë dhe ai i ndërtimtarisë shënuan rritjen më të lartë vjetore në TM4 - 2017. Kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsejtë kredive të ndërmarrjeve, u karakterizuan me rritje më të ngadalshme vjetore prej 30 milionë eurosh në periudhën raportuese (rritje prej 50 milionë eurosh në TM4 2016) dhe shënuan vlerën prej 785.8 milionë eurosh", thuhet në raportin e BQK-së.

Po sipas këtij raporti, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë ka përshpejtuar rritje, ku në TM4 - 2017 kreditë e distinuara për këtë sektor u rritën për 11.2 milionë euro dhe arritën në 136.4 milionë euro. "Gjatë kësaj periudhe, kreditë ndaj sektorit të bujqësisë, prodhimtarisë si dhe shërbimeve të tjera shënuan rritje, por që ishin dukshëm më të ulëta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM4 - 2017 u rritën për 22.9 milionë euro dhe arritën vlerën prej 897.6 milionë eurosh", është thënë në raportin e BQK-së, duke u shtuar se kjo rritje, ndër të tjera, reflekton ecurinë në kreditë e reja të lëshuara nga bankat gjatë kësaj periudhe. "Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe kreditë e reja të destinuara për konsum shënuan rritje, kurse kreditë e reja hipotekare shënuan rritje prej 24.5 milionë eurosh gjatë këtij tremujori që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, tregon për një rritje për 5.6 milionë euro. Vlera e kredive të lëshuara për qëllime konsumi në tremujorin e fundit të vitit 2017 arriti në 369.5 milionë euro, përderisa kreditë e reja hipotekare arritën vlerën prej 91.2 milionë eurosh", është thënë në raportin e BQK-së.




# Ministri Hasani merr vendim për themelimin e zonës ekonomike në Vushtrri

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, ka bërë me dije se ka marrë vendim për themelimin e zonës ekonomike në komunën e Vushtrrisë. Ai ka thënë se krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë, duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste. "Në mënyrë që t'u krijojmë kushte sa më të mira investitorëve potencialë, sot kam marrë vendim për themelimin e zonës ekonomike, respektivisht Parkut Industrial, në Lumadh, Komuna e Vushtrrisë, duke u bazuar në faktin se kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi janë plotësuar", ka thënë ministri Hasani. Ai ka shtuar se prona e paluajtshme në të cilën themelohet kjo zonë ekonomike është e regjistruar në emër të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe është në sipërfaqe prej 14. 86.00 hektarësh. "Besoj se me hapjen e kësaj zone do të mundësohet krijimi i vendeve të reja të punës të cilat do të ndikonin në zbutjen e varfërisë në këtë komunë!", ka pohuar ministri i MTI-së, Bajram Hasani.



# Nis ndërtimi i 'Aqua Parkut' në Mitrovicë

Mitrovicë, 25 prill (ER) - Kanë filluar punimet për ndërtimin e "Aqua Parkut" që ndodhet afër liqenit artificial në Mitrovicë. Investitorët e këtij projekti kanë bërë me dije se Parkut Ujor kap vlerën mbi 7 milionë euro.
Kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se ndërtimi i "Aqua Parkut" përgjatë lumit Ibër ka rëndësi të veçantë për turizmin në këtë qytet. Sipas tij, ky projekt do të përfundojë pas tre vjetësh. "Qëllimi im kryesor ka qenë të bëjë diçka të mirë për qytetarët e Mitrovicës. Mendoj se së bashku kemi arritur të kemi sot këtë projekt, ndoshta më i miri në Ballkan", ka thënë Bahtiri.
Afrim Durmishi, pronar i "Arjeta Group", që është një nga kompanitë investitore në "Aqua Park", ka pohuar se ky projekt në përfundim do të dalë shumë i bukur.






# Ambasada sllovene mbështet nxënësit e Skenderajt me bursa

Skenderaj, 25 prill (ER) - Ambasada e Sllovenisë në Kosovë do ta ndihmojë Komunën e Skenderajt në fushën e arsimit, për të cilën do të ndajë bursa për nxënës të kësaj komune. Kështu është bërë me dije të mërkurën pas takimit të zhvilluar ndërmjet ambasadorit slloven në Kosovë, Bojan Bertoncelj dhe kryetarit të Skenderajt, Bekim Jashari.
Ambasadori Bertoncelj ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur Komunën e Skenderajt edhe në fusha të tjera. Ai ka shtuar se me kryetarin Jashari kanë biseduar rreth mundësive që ndonjë kompani sllovene të vijë dhe të investojë në Skenderaj.
Ndërsa kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka shprehur mirënjohjen e tij ndaj Sllovenisë për mbështetjen e nxënësve të kësaj komune.
Gjatë qëndrimit në Skenderaj ambasadori slloven ka vizituar disa shkolla të kësaj komune.

# PDK-ja në Prizren fillon përgatitjet për formimin e Kabinetit për Qeverisje të Mirë

Prizren, 25 prill (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Dega në Prizren, në përputhje me vendimin e organeve drejtuese të saj, ka filluar përgatitjet për themelimin e Kabinetit të Qeverisjes së Mirë në këtë qytet. Sipas një njoftimi për medie nga kjo parti, është bërë me dije se Kabineti i Qeverisjes së Mirë do t'i ketë komisionet përkatëse me njohës të fushave në kuadër të qeverisjes lokale. "Në këtë rast do të përcillet dhe analizohet me vëmendje keqqeverisja e izoluar, jotransparente dhe jovendimmarrëse e kryetarit turist Mytaher Hakuka dhe koalicionit qeverisës. Kaluan njëqind ditët e qeverisjes me ankesa fiktive dhe postime në 'Fb', e gjitha kjo për ta arsyetuar mospunën e tij dhe kabinetit që drejton, si dhe duke bërë përpjekje që ta kamuflojë paaftësinë e tij, për t'iu ofruar zgjidhje problemeve të shumta që kanë qytetarët e komunës sonë", është thënë në komunikatën e PDK-së në Prizren.
PDK-ja në Prizren ka paralajmëruar se me qëllim të evidentimit të të gjitha shkeljeve ligjore që po bëhen nga ana e kësaj qeverie, pa program e vizion, kjo parti së shpejti do ta lansojë platformën elektronike përmes së cilës do t'u ofrojnë mundësi qytetarëve të Komunës së Prizrenit që t'i adresojnë të gjitha shqetësimet në raport me këtë qeverisje.




# Memorandum mirëkuptimi për restaurimin e Hamamit



Prishtinë, 25 prill (ER) - Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Prishtinës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Republikës së Turqisë (Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim - TIKA), lidhur me investimet në Hamamin e qytetit.
Qëllimi i këtij Memorandumi është zhvillimi i bashkëpunimit në kuadër të hartimit të projektit zbatues dhe zbatimin e projektit të restaurimit dhe rregullimit të oborrit të Hamamit të Madh, aset i mbrojtur sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore. MKRS-ja dhe Komuna e Prishtinës do t'i sigurojnë lejet dhe aprovimet e nevojshme për hartimin e projektit zbatues dhe zbatimin e projektit të cilat do të zhvillohen nga TIKA, si dhe do t'i sigurojnë lehtësimet e duhura për zgjidhjen e problemeve të mundshme që mund të lindin në fazën e hartimit të projektit zbatues.

## Kryetari Gashi tregon kushtet për investitorët

Prishtinë, 25 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka pritur të mërkurën një delegacion të kompanisë "Contour Global", e cila pritet ta ndërtojë termocentralin e ri në këtë komunë. Gashi gjatë këtij takimi ka bërë të qartë se çdo investitor mund të llogarisë në mbështetjen e tij personale dhe të gjitha aseteve që ka komuna. "Duhet të kemi parasysh se qytetarët e Obiliqit duhet të jenë pjesë e rëndësishme e çdo projekti që pritet të ndodhë në komunën tonë. Përfaqësuesve të kompanisë 'Contour Global' u është treguar edhe një herë se Komuna e Obiliqit nuk pranon asnjë marrëveshje bashkëpunimi në rast të mosrespektimit të Ligjit për Obiliqin dhe të drejtat e qytetarëve të komunës në punësim, mbrojtjen mjedisore, infrastrukturore dhe shëndetësi", ka thënë Gashi.



Në këtë epokë të dijeve dhe epokë digjitale

# Çfarë arsimi na duhet



Prof. ass. dr.
Ragip GJOSHI

Në ditët e sotme, kur para mësuesve shtrohen kërkesa të reja, atyre më tepër se një trajnim formal u nevojitet përpjekje për ta zbatuar një kurrikulë të re të edukimit. Andaj kjo ide dhe kjo situatë e re shpërfaqet rolin e universiteteve tona publike, të cilët me Ligjin e arsimit të lartë kanë të rezervuar të drejtën e përgatitjes së mësuesve të ri. Domethënë, gjendja aktuale shtron kërkesa të reja që përmes formave të reja të edukimit të ndërtojmë strategji dhe programe zhvillimi.

Kërkesat e kurrikulës bashkëkohore të bazuar në kompetenca, vënë në pah fatin se është tepër pak që mësuesit tanë të pajisen vetëm me diplomë dhe licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesisë. Sfidat e reja të shoqërisë që tashmë e kemi pagëzuar si "shoqëri e dijes", "erë globale", "epokë digjitale" dhe përkufizime të tjera metaforike e figurative, para sistemit arsimor të Kosovës, para MAShT-it, agjencive të specializuara në fushën e formimit të vazhdueshëm të mësuesve, shtrojnë detyra e kërkesa të reja të shumta. Kosova dhe sistemi i saj i arsimit ndodhen përballë një reforme sistematike, e cila kërkohet të jetë efikase dhe e qëndrueshme.

Në mesin e kërkesave do të shquhej nxitja e debatit dhe përpjekjeve institucionale e ligjore për gjetjen e formave për zhvillimin profesional të mësuesve, sepse ata janë çelësi i suksesit të realizimit të këtij projekti kombëtar për t'i shndërruar dijet dhe jo veç diplomat ekuivalente me ato që fitohen në shtetet e BE-së. Agjentët e realizimit të këtij synimi duhet të jenë të shumtë. Sa më të shumëfishta strategjitë e mbështetjes, edhe buxheti shtetëror duhet të shumëfishohet më shumë.

Shkolla është dera e parë ku promovohen shumë vlera të demokracisë.

Shkolla është vendi ku nis filli i ndryshimeve politike, ekonomike, të drejtësisë, shëndetësisë, arsimit, por edhe cilësia e qeverisjes së vendit. Në këtë kohë të globalizmit, arsimimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve u referohet politikave, programeve, strategjive dhe procedurave të hartuara për t'i pajisur mësuesit me njohuri, shprehi, shkathtësi, qëndrime, sjellje, aftësi dhe kompetenca, që ata kanë nevojë për t'i kryer detyrat e tyre të rëndësishme në mënyrë efektive në klasë, në shkollë dhe në komunitetin e më gjerë.

**Fuqia intelektuale e mësuesve kërkohet të shënojë një rritje të tipareve të erës globale...**

Është koha e fundit që politikëbërësit e arsimit t'i ndërmarrin të gjitha veprimet që reflektohen te fuqia intelektuale e mësuesve. Kjo fuqi intelektuale kërkohet të njohë një rritje dhe të përshkohet nga tipare të erës globale që drejtpërdrejt pasqyrohet te zhvillimi bashkëkohor në arsim në këtë epokë të dijeve dhe në këtë epokë digjitale. Prandaj, krahas reformimit kurrikular, reformimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe të teksteve mësimore e mjeteve mësimore, shtohet kërkesa parësore që këto reforma të jenë në bashkëveprim me reformat në arsimin e lartë. Në këtë pikë do të duhej të pajtohen të gjithë pjesëtarët e armatës së madhe që janë të përfshirë në gjithë zinxhirin e sistemit arsimor në të gjitha nivelet.

Besoj se është koha e fundit që universitetet, respektivisht Fakultetet e Edukimit, të punojnë shumë në planin e integruar të potencialit të tyre, por edhe të kërkuarit të ndihmesës dhe asistencës më të madhe të ekspertëve të jashtëm, që të përfshihen institucionalisht në skemën për zhvillimin profesional të mësuesve për gjatë gjithë jetës. Madje për këtë qëllim disa nga Fakultetet e Edukimit të universiteteve tona do të duhej të akreditojnë programe të veçanta për zhvillimin e mësuesve. Kjo përpjekje institucionale do të duhej të bëhej për shumë arsye.

Reforma duhet të thellohet e të zgjerohet për arsye se: a) sistemi arsimor në Republikën e Kosovës është në një etapë të re zhvillimit, në atë të sigurimit të cilësisë, ndërkohë që kjo hallkë përballet me sfida; b) se zhvillimet e brendshme dhe dinamika e interesave të tregut të punës dhe të nxënësve e studentëve, bazuar kushtet e kërkesave për integrim në kuadrin evropian të kualifikimit dhe zhvillimit të kompetencave të profesioneve, kane ecur shumë para; c) sepse sistemi arsimor po përballet me tendencën e zgjidhjeve pragmatike, duke devijuar shpesh përputhshmërinë e reformave me koherencën me realitetin e shkollës; d) sepse në kushtet e reformës në proces, ndryshimet kërkojnë sinkronizim të lëvizjeve nga lart dhe poshtë.

Reforma duhet të shtrihet fuqishëm, e për këtë arsye mund të konkludohet se është kërkesë imediate e kohës që universitetet publike të marrin përgjegjësi kombëtare për cilësinë e të nxënit dhe atë të mësuesve, duke bërë që mësuesit e dalë prej tyre të mos nëpërkëmben dhe të mos mbeten në dorën e OJQ-ve, të cilat, me gjithë "kapacitetet" që kanë, nuk mbajnë përgjegjësi për atë çfarë u ofrojnë mësuesve: Kur? Sa? Si? Për këto arsye dhe shumë të tjera, sistemi arsimor parauniversitar i Kosovës duhet t'u bëjë apel universiteteve për të marrë më shumë përgjegjësi dhe për të ofruar risi konceptuale mbi synimet e reformës për më shumë cilësi, për më shumë të mësuar për gjatë gjithë jetës, për më shumë kompetenca dhe performancë, për më shumë koherencë në kurrikulat, për më shumë gjithëpërfshirje dhe përdorim të teknologjive bashkëkohore në mësimdhënie, sidomos në hartimin e teksteve të reja mësimore që janë vonuar shumë. Hartimi dhe botimi i teksteve të reja është dashur të jetë i sinkronizuar me dinamikën e zbatimit të kurrikulës së re.

Duke ndaluar në situatën aktuale, vihet re se pesha për formimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, për të cilët më shumë po shqetësohen disa OJQ, të cilat, financiarisht, janë bërë edhe më të fuqishme se vetë MAShT-i. Me gjithë lëvizjet pozitive të reformimit kurrikular dhe të zhvillimit profesional të mësuesve që po bëhet, duke u mbështetur edhe në dispozitat aktuale për formimin e zhvillimin e vazhdueshëm të mësuesve, duket se shpesh proceset e formimit të mësuesve po degradojnë dhe qëllimi dhe pikësynimi po rrudhet. Roli i trajnerëve për çështje shumë të mëdha kurrikulare po shoqërohet me dobësi dhe mangësi në formimin e tyre. Një çështje tjetër degraduese është edhe organizimi i trajnimeve formale sa për të figuruar në dosjet e mësuesve një dëshmi se ata kanë përmbushur një kërkesë ligjore. Pikërisht për shkak të këtyre dobësive dhe të tjerave që opinioni arsimor i ka të ditura, këto devijime e të meta mund t'i korrigjojnë veç universitetet tona publike. Universitetet tona kërkohet ta luajnë rolin e akreditimit të këtyre kapaciteteve dhe të vënë kontroll në rrugë shkencore e institucionale. Këta organizma duhet të konkurrojnë në universitete dhe të certifikohen zyrtarisht. Po ashtu, këto certifikata të jenë rezultat i kontrollit të cilësisë dhe jo vetëm i një pjesëmarrjeje të pasigurt dhe të kontrolluar.

Zhvillimi profesional i mësuesve nuk duhet lënë në dëshirën e individit, i cili kërkon dhe gjen lehtësira. Mësimdhënia për të maksimalizuar të nxënit, arritjet dhe cilësia e të nxënit është e garantuar në këtë udhë institucionale. Në këtë kontekst të ri, mësuesve, më tepër se një trajnim, iu nevojitet një kurrikulë e re edukimi, një tekst bashkëkohor, mjete mësimore bashkëkohore dhe teknologji e metodologji të reja mësimore. Është kohë e fundit qe të dalë në pah roli i universiteteve, veçanërisht i Fakulteteve të Edukimit, të cilët, përmes formave të reja të edukimit, duhet të ndërtojnë strategji dhe programe të zhvillimit të vazhdueshëm. Për arritjen e një mësimdhënie bashkëkohore e për të maksimalizuar të nxënit, universitetet duhen të jenë ndihmësit më të afërt të mësuesve, pasi aty është vendi i strategjive bashkëkohore të mësimdhënies. **(Vijon)**



## Deputetja ruse, që është në listë të zezë të ShBA-së, viziton Serbinë



BEOGRAD, 25 PRILL - Deputetja e Dhomës së Ulët të Parlamentit rus, e zgjedhur në zgjedhjet në Krime, Natalija Poklonskaja, ndodhej për vizitë në Serbi, ku takoi anëtarët e Këshillit të Asamblesë së Serbisë për diasporën dhe serbët në rajon. Poklonskaja nga viti 2014 deri më 2016 ka qenë prokurore në Krime, pasi ky rajon ukrainas është aneksuar nga Rusia. Për shkak të përfshirjes në krizën në Ukrainë, Poklonskaja nga viti 2014 është në listën e zezë të Ministrisë së Financave të ShBA-së dhe të Bashkimit Evropian, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë. Autoritetet ukrainase e kanë futur Poklonskajën në listën e të kërkuarve, duke e akuzuar për "aktivitete për ndryshimin e dhunshëm të rendit kushtetues". Beogradi zyrtar e trajton Krimenë si pjesë të Ukrainës dhe nuk e njeh aneksimin rus.

# Turqia e revoltuar për ndalimin e fushatës elektorale në Evropë

Austria, Gjermania dhe Holanda kanë thënë se nuk do të lejojnë fushatë zgjedhore në vendet e tyre ku ka një popullsi të konsiderueshme emigrantësh nga Turqia, kurse presidenti Erdogan ka sinjalizuar se mund ta thyejë embargon e tyre elektorale



ANKARA, 25 PRILL - Zgjedhjet e parakohshme në Turqi ka të ngjarë të shoqërohen me përplasje mes Ankarasë dhe autoriteteve të Austrisë, Gjermanisë dhe Holandës që kanë thënë se nuk do të lejojnë fushatë zgjedhore në vendet e tyre ku ka një popullsi të konsiderueshme emigrantësh nga Turqia.

Nga ana e tij, presidenti Erdogan ka sinjalizuar se mund të thyejë embargon e tyre elektorale. "Nuk do e përmend vendin përkatës, por do t'u flas qytetarëve turq në një palestër në Evropë, që zë rreth 10 mijë vetë," tha presidenti turk.

Gjermania e ka shprehur hapur qëndrimin e saj për synimet e presidentit turk për fushatë. "Ne mbajmë një qëndrim të fortë në këtë drejtim. Fushata në interes të një vendi tjetër në Gjermani nuk lejohet tre muaj para zgjedhjeve", tha ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas.

Qeveria austriake dhe ajo holandeze po zbatojnë rregullore të ngjashme. "Fjalimet e politikanëve turq në kuadër të fushatës nuk janë të mirëpritura në Austri dhe nuk do të lejohen", tha kancelari austriak Sebastian Kurz. "Nga njëra anë bllokojnë ushtrimin e një prej të drejtave më themelore, nga ana tjetër kritikojnë ato që i quajnë zhvillime negative në demokracinë turke," reagoi ministri turk për Marrëdhënie me Bashkimin Evropian, Omer Celik.

Ndalimi i aktivitetit për fushatë në Evropë shihet si një goditje ndaj përpjekjeve të Erdoganit për rizgjedhje. "Erdogani ka një stil shumë konkret, do që ta shohin zgjedhësit. Ai beson se ka përkrahës të shumtë në Evropë," thotë analisti politik Semih Idiz i cili shkruan për portalin elektronik Al-Monitor. "Votuesit në Evropë janë shumë të rëndësishëm pasi ka një numër të madh emigrantësh me të drejtë vote. Ndoshta 4.5 milionë vetë. Ndikimi i tyre nuk mund të injorohet", thotë opinionisti.

Analistët thonë se votuesit turq në Evropë kanë prirjen të mbështesin Erdoganin dhe partinë e tij AKP. Ata shtojnë se kjo përkrahje mund të ketë rëndësi vendimtare në zgjedhjet e qershorit.

Referendumi i vjetshëm për ta shndërruar Turqinë në presidencë ekzekutive solli krizë në marrëdhëniet Ankara-BE. Holanda dhe Gjermania shprehën kritika të forta në veçanti dhe bllokuan planet për tubime pasi autoritetet shprehën shqetësim se aktivitete të tilla mund të acaronin tensionet.

Presidenti turk u përgjigj duke i akuzuar dy vendet se po silleshin si regjime naziste.

Analistët thonë se retorika e fortë e Erdoganit në këtë acarim e fuqizoi fushatën e tij dhe solli si rezultat miratimin e referendumit.

Disa vëzhgues thonë se ndalimi i aktiviteteve elektorale për zgjedhjet e ardhshme mund të rezultojë në favor të Erdoganit. "Vështirë të besosh se Gjermania, Austria, autoritetet holandeze nuk e kuptojnë se duke ia vështirësuar fushatën partisë AKP, e shtojnë përkrahjen për këtë forcë politike dhe i sigurojnë fitoren udhëheqësit të saj", thotë opinionisti Barcin Yinanc.

# Mogherini: Marrëveshja me Iranin duhet të ruhet



BRUKSEL, 25 PRILL - Shefja për politikë të jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, tha se marrëveshja aktuale bërthamore me Iranin po funksionon dhe se ajo "duhet të ruhet".

Komentet e saj vijnë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe homologu i tij francez, Emmanuel Macron, bënë thirrje për marrëveshje të re me Teheranin.

Me marrëveshjen e vitit 2015, Irani është dakorduar të frenojë programin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare.

Por, Trumpi ka kërcënuar se do të tërhiqet nga ajo, nëse Republika Islamike nuk heq dorë edhe nga programi me raketa balistike deri më 12 maj.

Në takim me Macronin në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi e cilësoi marrëveshjen si "të çmendur", ndërsa Macroni tha se dëshiron të punojë për një marrëveshje të re.

Mogherini, e cila e ka mbrojtur me vendosmëri marrëveshjen, tha se ajo po funksionon dhe se është thelbësore për sigurinë evropiane.

"Se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, do të shohim ditëve në vijim. Por, tani ekziston një marrëveshje, po funksionon dhe ajo duhet të ruhet", tha Mogherini.

Marrëveshja bërthamore është nënshkruar në vitin 2015 nga Irani, ShBA-ja, Rusia, Kina, Britania, Franca dhe Gjermania.

## Rikthehen protestat kundër pushtetit në Armeni



JEREVAN, 25 PRILL - Udhëheqësi i protestave në Armeni, Nikol Pashinian, nisi valën e re të demonstratave në rrugët e Jerevanit, duke i kërkuar Partisë Republikane në pushtet të heqë dorë nga qeverisja.

Dy ditë më parë, kryeministri armen, Serzh Sarkisian, i cili paraprakisht ka shërbyer dhjetë vjet si president, ka dhënë dorëheqje, për shkak të protestave kundër tij. "Mendoj se revolucioni ynë jo i dhunshëm, i kadifenjtë ka dërguar mesazh të qartë se Partia Republikane nuk mund të jetë më në pushtet", tha Pashinian. "Kërkojmë nga Partia Republikane të dorëzojë pushtetin dhe pa mëdyshje të njohë fitoren e popullit", tha ai para turmës.

Protestat e reja vijnë pas anulimit të bisedimeve të planifikuara midis Pashinianit dhe ushtruesit të detyrës së kryeministrit, Karen Karapetian, anëtar i Partisë Republikane, i cili ka thënë se nuk i pranon kushtet e Pashinianit për negociata.

Ligjvënësi i opozitës, Pashinian, po bën thirrje për zgjedhje të menjëhershme në parlament, i cili tani është i dominuar nga Partia Republikane, dhe për një "kandidat të popullit" që të zgjidhet kryeministër i përkohshëm derisa të mbahen zgjedhjet.

Republika e Shqipërisë, 3 390 burime turistike

# Një vend i vogël me pasuri të mëdha

Sipas statistikave të "Instat"-it, në tre muajt e parë të vitit kanë hyrë 677 mijë shtetas të huaj në Shqipëri, me një rritje prej 12.5 përqindësh në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shifra e gjithë burimeve turistike në Shqipëri sipas një bilanci të bërë së fundmi dhe të publikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është 3 390 sish





TIRANË, 25 PRILL - E njihni mirë Shqipërinë me vendet turistike dhe burimet e saj? Kur themi burimet nënkuptojmë që nga pikat kulturore, monumente të natyrës si shpella, kanione apo edhe objekte kulti.
Shifra e gjithë burimeve turistike sipas një bilanci të bërë së fundmi dhe të publikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është 3 390 sish.
Qarku me pasuritë më të mëdha është ai i Gjirokastrës me 697 burime që nis me Kalanë e qytetit që është më përfaqësuesja dhe mbyllet me qytezën e Dedjanit në Përmet. Gjirokastra ndiqet nga Berati, me 569 burime turistike që edhe në këtë rast nisin me kalanë e qytetit pasohet nga kalaja e Krotinës, ajo e Mjeshtovës e me radhë lista mbyllet me Kroin Mbret dhe Kanionet e Xhunovës.
Qarqet me pasuri më modeste janë Durrësi dhe Lezha me nga 98 burime turistike në listën e tyre ndërkohë që Fieri ka vetëm 92.
Por edhe pse Shqipëria ka kaq shumë burime vetëm një pjesë e këtyre atraksioneve janë promovuar apo bërë pjesë e guidave turistike.
Tendenca e vizitave është drejt pikave më simbolike ndërkohë që turizmi i aventurës përmes grupeve të veçanta që organizohen fundjavave po eksperimenton viteve të fundit në destinacione të reja. Të tilla janë lumi i Shalës i konsideruar si Tajlanda Shqiptare, Ujvara e Sotirës apo Kanionet e Osumit.
Edhe në kryeqytet ka gjithmonë e më shumë interes për të vizituar rrethinat ku përveç Petrelës, Prezës apo Dajtit që kanë kohë që janë pjesë e agjendës së fundjavave janë shtuar edhe pika të tilla si Syri I Ciklopit, Kanionet e Erzenit e një seri atraksionesh të tjera.



Shqipëria ka qenë vitin e fundit në fokusin e mediave të huaja që promovonin bukuritë e vendit, ndërsa dhe numri i vizitorëve është rritur ndjeshëm. Burtinti, berati, Gjirokastra, Kalaja e Krujës, apo dhe bregdeti janë destinacionet që u bëjnë më shumë përshtypje mediave të huaja.
Sipas statistikave të "Instat", në tre muajt e parë të vitit kanë hyrë 677 mijë shtetas të huaj, me një rritje prej 12.5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
Në sezonin e verës pritet që turistët e huaj të shënojnë sërish rritje.
Hotelet kanë raportuar se ata janë prenotuar tashmë, ku kryesorët janë sërish polakët, ka rritje të ukrainase dhe risi këtë vit janë nordikët, që kanë rezervuar në Durrës përmes agjencisë "Apollo".









# Kolegji AAB mban konferencën studentore ndërkombëtare

**Prishtinë, 25 prill (ER)** - Në Kolegjin AAB të mërkurën ka filluar punimet Konferenca Ndërkombëtare Studentore, në të cilën po marrin pjesë një numër i madh i studentëve nga vendi, rajoni dhe nga bota.
Hapjen e kësaj konference e ka bërë prorektori për Shkencë i Kolegjit AAB, prof. Hasan Saliu, i cili ka thënë se Kolegji AAB gjatë gjithë kohës organizon konferenca shkencore.
Ai ka thënë se kjo konferencë kërkimore ndërkombëtare sot është vetëm një vazhdim dhe angazhim tjetër i studentëve tanë. "Kolegji AAB deri më tani ka organizuar disa konferenca shkencore ndërkombëtare nga fusha të ndryshme studimi, si ato të komunikimeve dhe studimeve mediatike, të drejtësisë, psikologjisë, konferenca të ekonomisë, ajo e çështjeve sociale, linguistikës etj. Këto konferenca janë organizuar në AAB në partneritet të ndryshëm rajonal e ndërkombëtar, me Universitetin e Tiranës, të Elbasanit, të Sarajevës, të Osjekut, Universitetin e Peruxhës, ndërsa në qershorin e kaluar një panel i ishte rezervuar AAB-së nga Universiteti publik i Milanos", ka thënë Saliu.




Punimet e Konferencës Studentore Ndërkombëtare i ka përshëndetur edhe kryetarja e Unionit Studentor të Kolegjit AAB, Flaka Vitaku. Ajo ka thënë se Unioni Studentor i Kolegjit AAB është duke bërë një punë të mirë dhe me shumë entuziazëm.
Me këtë rast, ajo ka përmendur disa aktivitete me rëndësi që janë zhvilluar në kuadër të këtij unioni, si: krijimi i eventeve të ndryshme, debate publike me studentët dhe aktivitete të ndryshme nacionale.
Studentët pjesëmarrës potencuan se kjo konferencë është një mundësi e përsosur për t'i prezantuar kërkimet e tyre, për të krijuar miq të rinj, për t'u argëtuar dhe për ta njohur Kosovën.

E jashtëzakonshme

# Porosit shampon online, i sjellin 20 pasaporta amerikane



Një grua që bleu shampon online është habitur kur hapi pakon dhe gjeti brenda 20 pasaporta amerikane. Nicole Mitchell nuk po u besonte syve kur hapi pakon që posta i solli dhe që përmbante dokumente konfidenciale të destinuara për Ambasadën Amerikane, në vend të shamponit.

FOTO E DITES



Ura e gurit në grykën e Rugovës. Foto: Granit Dinaj

E rrallë

# Macja me kancer "gjen zgjidhje" tek vaji i kanabisit



Një mace, e cila pothuajse humbi "9 jetët e saj" pasi u prek nga kanceri, po rikuperohet përsëri për shkak të përdorimit të vajit të kanabisit. Macja e quajtur "Ginge" ishte afër ngordhjes, kur në njërën prej këmbëve të saj u zhvillua një tumor i madh. Brenda vetëm dy ditëve të vendosjes së pesë pikave të vajit në ushqimin e Ginges, tumori i maces u zvogëlua me shpejtësi dhe ajo sot është shumë mirë.

## BARSOLETA E DITËS



**Si thuhet anglisht "Vjehrra ime nuk do të vijë për darkë sonte?" Përgjigjja: "Yeeesss"!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

### "BLACK PANTHER" 3D (PG-13)



Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

### "PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck

Në ora19:00

### "PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)



Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora21:00

### "RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Personat pranë jush janë disi të bezdisur nga sjellja juaj kohet e fundit. Do të preferonin t'ju shihnin siç keni qenë gjithmonë.



**DEMI**
Ne të ardhmen nuk keni pse fshiheni pas premtimeve boshe që ju kanë bërë. Është mirë të filloni të krijoni pavarësinë tuaj dhe t'i ripërtërini marrëdhëniet.



**BINJAKËT**
Megjithëse jeni përpjekur me mish e më shpirt të përfundoni një projekt të caktuar, kushtet dhe rrethanat nuk ua kanë lejuar këtë gjë.



**GAFORRJA**
Lejojini një personi t'ju japë zgjidhjet e veta sot. Me pak mbështetje mund të bëhet aleati më i mirë i juaji në të ardhmen.



**LUANI**
Aktivitetet që keni për sot mos i shtyni për një afat të pacaktuar. Shumë gjëra do të jenë në varësi të situatave të krijuara ditën e sotme.



**VIRGJERESHA**
Nuk keni një gjykim të drejtë mbi situata dhe persona të caktuar. Prisni të jeni të sigurt përpara se të shprehni opinionin tuaj.



**PESHORJA**
Do të ndikoheni nga persona që do t'ia u ndryshojnë totalisht këndvështrimin e gjërave. Jeni bëre fleksibel kohet e fundit.



**AKREPI**
Sot duhet të lini mënjanë krenarinë tuaj dhe të bëni ç'është e mundur për të finalizuar një projekt të përbashkët. Do të shpërbleheni për mundin.



**SHIGJETARI**
Çdo gjë që keni zgjedhur të bëni sot do të përkojë me planet tuaja për ditën. Jeni me të qetë kur bëni një planifikim paraprak.



**BRICJAPI**
Shumë njerëz mësojnë nga gabimet e tyre dhe e njëjta gjë do t'ju ndodhë edhe ju. Eksperienca ju ka bërë me të ftohtë në marrëdhënie.



**UJORI**
Keni bërë zgjedhje të rëndësishme dhe sot nuk mund të ktheheni pas edhe nëse do të dëshironit. Pak me fleksibël në raport me partnerin sot.



**PESHQIT**
Po vini në pikëpyetje të gjitha gjërat që një person i afërt ka bërë për ju. Shumë shpejt do ta kuptoni që keni gabuar në disa raste.

# Dwayne Johnson bëhet baba për herë të tretë



Aktori i famshëm, Dwayne Johnson, i njohur për publikun si "The Rock" është bërë baba për herë të tretë. Lajmin e ka dhënë vetë aktori i cili ka postuar në rrjetin social "Instagram" një fotografi ku shfaqet duke mbajtur të bijën në kraharor dhe një dedikim të gjatë për vogëlushen.

# Meek Mill lirohet nga burgu



Meek Mill u lirua në fillim të kësaj jave nga burgu. Gjykata supreme e Pensilvanisë mori vendimin për ta lëshuar reperin, raporton "TMZ". "Dua të falënderoj Perëndinë, familjen, miqtë, avokatët dhe ekipin tim në Roc Nation, duke përfshirë Jay-z, Desiree Perez, mikun tim të mirë Miachel Rubin, fansat e mi dhe gjykatën supreme për dashurinë dhe mbështetjen dhe inkurajimin e tyre gjatë kësaj kohe të vështirë", ka deklaruar Meek.

# BTS po rikthehet me befasi



BTS po kthehen në skenën e Billboard Music Awards, ku këtë herë do të debutojnë me një këngë të re. Lajmi u bë me dije nga Billboard Music. Një vit më parë, grupi nga Korea e Jugut dërgoi dashuri përmes medieve sociale për fitoren e tyre historike për "Top Social Artist" gjatë ceremonisë. BTS ka paralajmëruar se po kthehen me diçka të madhe më 20 maj.



# Supermodelja e famshme tregon se e ka bërë hundën operacion

Supermodelja e famshme, Tyra Banks ka treguar se në fillimet karrierës së saj kishte zgjedhur t'i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjike në hundë për ta rregulluar një defekt në hundë që e kishte shkaktuar gjatë një lëndimi si fëmijë. 44-vjeçarja ka rrëfyer se edhe të famshmit më të mëdhenj nuk janë të përsosur. "Shihet qartë tek unë se e kam operuar hundën", ka thënë ajo për "E! News".


## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Hikmete Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

▶ Artan Kabashaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Dashnor Metaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Sinan Bajraktari shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Fidan Ibru shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Fehmi Thaçi shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Sherife Gashi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Bekim Saipi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një garsoniere për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 20.000 euro. Informatat në tel: 049 472 770

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.




# Sport




| PROGNOZA SPORTIVE | ARSENAL - ATLETICO MADRID | GG | MARSEILLE - SV SALZBURG | 3+ | AL AHLY - ZAMALEK | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Fetahaj: Titulli dhe Kupa i takojnë Prishtinës

Mesfushori Liridon Fetahaj ka thënë se Prishtina në këtë edicion do të ketë një sukses të madh. Sipas tij, kryeqytetasit do të triumfojnë në garën për titull dhe Kupë. "Ne jemi duke punuar në maksimum dhe besojmë se do të shpallemi kampionë. Jemi të fokusuar vetëm te ndeshjet tona dhe nuk na intereson se çfarë bëjnë kundërshtarët", ka thënë Fetahaj për "Epokën e re"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 25 prill** - Tri pikë është diferenca e pikëve në mes të skuadrës së Prishtinës dhe lideres së Vala Superligës së Kosovës në futboll, Dritës së Gjilanit, kur kanë mbetur edhe pesë javë deri në fund të kampionatit. Pavarësisht prej kësaj diference me skuadrën kryesuese, Liridon Fetahaj shpreh optimizëm se në fund do të jetë skuadra nga kryeqyteti që do të shpallet kampione e elitës. "Ne jemi duke punuar në maksimum dhe besojmë se do të shpallemi kampionë. Jemi të fokusuar vetëm te ndeshjet tona dhe nuk na intereson se çfarë bëjnë kundërshtarët", ka thënë Fetahaj për "Epokën e re".



Futbollisti nga Prizreni e pranon se Prishtina ka qenë e dëmtuar në mungesën e fushës së saj por, sipas tij, kjo nuk do të thotë se "bardhekaltrit" do ta mbyllin sezonin pa trofe. Një sukses tjetër Prishtina synon edhe në garën e Kupës, ku për kundërshtar e ka Vëllaznimin nga Gjakova. "Ne Kupë kemi treguar performacë të mirë dhe tash në finale e kemi kundërshtar Vëllaznimin, i cili është i vështirë, por synimi ynë është ta ngrehim Kupën lart. Ky është një sezon ku e kemi mundësinë ta fitojmë titullin, Kupën, më pas të dalim në Evropë", ka shtuar ai.

Ndeshjen e radhës Prishtina e zhvillon si vendëse në Pejë ndaj skuadrës së Llapit. Fetahaj e vlerëson skuadrën kundërshtare, por premton tri pikë të reja në rrugëtimin drejt titullit. "Synimi ynë është titulli, prandaj nuk bën të gabojmë kundër Llapit që është një kundërshtar mjaft i fortë, i organizuar mirë dhe me lojtarë cilësorë", ka deklaruar Fetahaj.

Prishtina nga 28 ndeshje ka grumbulluar 53 pikë, kurse ka regjistruar 15 fitore, 8 barazime dhe 5 humbje.

## SHKURT

### Xhudistët mësojnë shortin për Kampionatin Evropian "Tel Aviv 2018"

Është hedhur shorti për kampionatin evropian të xhudos, që do të mbahet në Tel Aviv të Izraelit, prej 26-28 prillit. Kosova do të përfaqësohet me katër xhudistë: Distria Krasniqi (-52 kg), Nora Gjakova (-57 kg), Loriana Kuka (-78 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg).

Distria rrethin e parë e kalon pa luftë, ndërsa në të dytin pret fituesen e çiftit Skripnik të Bjellorusisë dhe Penkowska të Polonisë.

Nora Gjakova në rrethin e parë takohet me Ichinkorlo Munkhtsedev të Azerbajxhanit.

Loriana Kuka do të përballet me Klara Apotekar të Sllovenisë, medaliste e artë në Kampionatin Evropian U-21, të mbajtur vitin e kaluar në Maribor.

Ndërkohë, Akil Gjakova rrethin e parë e kalon pa luftë, ndërsa në të dytin përballet me Cedric Bessi të Monakos.

Evropiani fillon nesër (e enjte) dhe zgjatë deri të shtunën.

Kampione e trefishë evropiane (2014, 2016 dhe 2017) është Majlinda Kelmendi, e cila këtë herë mungon shkaku i lëndimit.

### Posthumusi vlerëson lart futbollistet e Lepencit

Holandezi Erwin Posthumus zyrtarisht ka nisur punën në Klubin e Futbollit KF Lepenci në konkurrencën e femrave. KF Lepenci nëpërmjet një njoftimi për medie bën me dije se trajneri nga Volendami ka mbajtur seancën e parë në skuadrën e Lepencit.

"Ashtu siç informuam ditë më parë, trajneri i ekipit, Erwin Posthumus, ka mbajtur treningun e parë me ekipin e vajzave, i cili ishte shumë i kënaqur me talentin e futbollisteve dhe interesimin shumë të madh të vajzave për t'u marrë me futboll, ku të pranishme ishin 32 futbolliste", thuhet në njoftimin e KF Lepenci.

# Ish-kapiteni i Serbisë në fanellën e Kosovës

Ish-anëtari i të gjitha përzgjedhjeve të të rinjve të përfaqësueses së Serbisë në futboll, Arton Zekaj, së shpejti do të mundë të veshë fanellën e shtetit, siç e quan "Blici" i Beogradit, të rremë të Kosovës. Ish-juniori i Partizanit dhe kapiteni i përfaqësueseve të rinjve të Serbisë ka marrë ofertë nga Fadil Vokrri, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, që të luajë për ekipin kombëtar të tij. "Ftesa ka mbërritur, por duhet të mendoj mirë para se të vendos. Ende s'kam vendosur", i ka thënë Zekaj, 18 vjeç, gazetës "Blic" të Beogradit. I pyetur nëse ka frikë nga reagimet në Serbi, vendit ku ka lindur, Artoni është përgjigjur: "Jo, nuk ma thotë mendja të kem probleme. Kjo varet nga shumë rrethana. Unë jam i lindur në Sombor, kam pasaportë serbe, kam luajtur për Partizanin dhe kategoritë e reja të Serbisë, dhe kam qenë kapiten i tyre. Ta dini, sikur të dija se në të ardhmen do të kem ftesë për përfaqësuesen tonë A, do të mbetesha me fanellën e 'orlica'", citon gazeta Artonin.

Aktualisht Zekaj është anëtar i "Sopotit" dhe lojtari më i mirë i ligës së tretë të Serbisë. "Ne kemi treguar interesim të madh që anëtari i përfaqësueses së të rinjve të Serbisë të paraqitet në përfaqësuesen e Kosovës. I njohim mirë cilësitë e tij dhe shpresojmë se në fund çdo gjë do të dalë mirë. Ai në fund vendos vetë, pastaj si për të gjithë lojtarët pason procedura e lidhur me kërkesën e FIFA-s dhe shpresojmë për leje përfundimtare. Shpresoj të mos ketë kurrfarë problemesh. Ai është me origjinë nga Kosova, ndërsa ardhja e tij do të ishte shumë e rëndësishme për ne", i ka thënë TV Kosova 2 (në gjuhën serbe) kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Zekaj luan në pozitën e mesfushorit.

## Sonte gjysmëfinalet e para në Evropa Ligë

**Prishtinë, 25 prill** - Sonte (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet e para në kuadër të gjysmëfinaleve të Evropa Ligës. Arsenali i Granit Xhakës dhe Shkodran Mustafit e pret skuadrën e Atletico Madridit. Pra, kjo është edhe ndeshja kryesore për faktin se skuadra që arrin në finale llogaritet edhe favorite për ta fituar trofeun e kësaj gare. Në ndeshjen tjetër takohen Marseille dhe Salzburgu, ku luan me sukses reprezentuesi i Kosovës, Valon Berisha. Francezët cilësohen favoritë në përballjen e parë, por austriakët kanë bërë mjaft befasi në këtë edicion dhe nxjerrja e një rezultati pozitiv në Francë nuk është një gjë e pamundur.

Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 21:05.



## Grezda: Më pëlqen futbolli gjerman



TIRANË, 25 PRILL - Reprezentuesi i Shqipërisë në futboll, Eros Grezda, në një intervistë për "Panorama Sport", ka bërë me dije edhe një herë se i pëlqen transferimi në futbollin gjerman. "Kisha një sezon mjaft të mirë dhe gjithçka po ecte mirë. Kisha disa mundësi, për të cilat nuk mund t'i quaj as oferta, pasi nuk ishin zyrtare, por vetëm interesime. Tani nuk e di se sa do të ndikojë dëmtimi dhe se çfarë do të ndodhë me klubet. Nuk e kam menduar ende largimin. Dua të kontribuoj me sa kam mundësi për Osijekun për sa kohë jam në këtë ekip. Më pëlqen kampionati gjerman".

# MKRS-ja, 500 mijë euro për sportin në Ferizaj

PRISHTINË, 25 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu. Në këtë takim në mes të MKRS-së dhe Komunës së Ferizajt janë nënshkruar dy memorandume bashkëpunimi për mbështetjen financiare për realizimin e projekteve "Ndërtimi i Sallës Sportive në Greme të Ferizajt" për të cilin MKRS-ja investon 300 mijë euro dhe "Renovimin e stadiumit të futbollit në Ferizaj" për të cilin MKRS-ja investon 200 mijë euro, investime të cilat do të bëhen gjatë vitit 2018.



Ministri Gashi ka thënë se këto investime po bëhen me qëllim të krijimit dhe avancimit të infrastrukturës sportive. "Pas këtyre investimeve të rinjtë e Ferizajt dhe sportistët e këtij qyteti do të kenë mundësi më të mira për realizimin e aktiviteteve të tyre sportive. Ne si Ministri jemi të përkushtuar t'i ndihmojmë komunat për realizimin e projekteve kapitale dhe për plotësimin e infrastrukturës sportive. Edhe memorandumet e nënshkruara sot me kryetarin Aliu janë në këtë vazhdë", ka thënë Gashi.

Ndërsa i pari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, është shprehur i kënaqur për nënshkrimin për renovimin e stadiumit.

# Warriorsi e Philadelphia kualifikohen në gjysmëfinale

PHILADELPHIA, 25 PRILL - Skuadra e Golden State, kampione e NBA-së, ka siguruar kualifikimin në gjysmëfinalet e "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 99-91 ndaj San Antonio Spursit, në çerekfinalen e pestë. Kampionët e Warriorsit nuk toleruan ndaj një rivali të fortë si Spursi, në një përballje të dominuar prej tyre, duke prerë një biletë për më tej. Duranti me 25 pikë e Thompsoni me 24 bënë diferencën në parket për Golden Staten, ndërsa për Spursin nuk mjaftuan 30 pikët e Aldridges për ta evituar humbjen dhe eliminimin nga "play-off"-i.



Në Lindje, kualifikohet për në gjysmëfinale skuadra e Philadelphia, që mundi 104-91 ekipin e Miamit, ndeshje e dominuar nga vendësit. Një kualifikim që Philadelphia nuk e vuri asnjëherë në dyshim, me Reddickun që realizoi 27 pikë. Një fitore larg kualifikimit për në gjysmëfinale është edhe ekipi i Bostonit, që mundi 92-87 Milwaukee dhe udhëheq 3-2 serinë e ndeshjeve. Celticsi dominoi në ndeshje, falë 22 pikëve e 14 rebaundeve të Horfordit, por në fund rrezikoi shumë, pasi Middletoni (23 pikë) tentoi përmbysjen për miqtë, por pa sukses.

| | |
|---|---|
| KONFERENCA E LINDJES | |
| 1-8 **Toronto - Washington** | (barazim 2-2 me ndeshje) |
| 2-7 **Boston - Milwaukee** | 92-87 (3-2 me ndeshje) |
| 3-6 **Philadelphia - Miami** | 104-91 (4-1 me ndeshje) |
| 4-5 **Cleveland - Indiana** | (barazim 2-2 me ndeshje) |
| KONFERENCA E PERËNDIMIT | |
| 1-8 **Houston - Minnesota** | (3-1 me ndeshje) |
| 2-7 **Golden State - San Antonio** | 99-91 (4-1 me ndeshje) |
| 3-6 **Portland - New Orleans** | (0-4 me ndeshje) |
| 4-5 **Oklahoma - Utah Jazz** | (1-3 me ndeshje) |

## SHKURT

### Chelsea i shtohet garës për Hysajn

Paraqitjet e mira të Elseid Hysajt me skuadrën e Napolit kanë ndikuar që shumë skuadra të interesohen për transferimin e tij në afatin kalimtar të verës. Mediat italiane kanë raportuar se menaxheri i Hysajt, Mario Giuffredi, ditët e fundit ka udhëtuar drejt Anglisë, ku ka organizuar disa takime me përfaqësues të Chelseat, të cilët po këmbëngulin për kartonin e futbollistit kuqezi. Interesim për Hysajn kanë shfaqur edhe Liverpooli, Manchester Unitedi dhe Bayern Mucheni.

### Besa triumfon në turneun "Shkëlzen Haradinaj"

Besa e Pejës e ka fituar edicionin e pestë të turneut tradicional në futsall "Shkëlzen Haradinaj", i cili është mbajtur në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë në organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Në ndeshjen finale, pas një loje mjaft interesante, rivalizuese, e me plot aksione atraktive, skuadra pejane iu gëzua fitores kundër Feniksit nga Drenasi, me rezultat 2-1. Besa kaloi në epërsi në minutën e dytë me golin e Agon Rexhës. Feniksi reagoi shpejt dhe barazoi rezultatin me golin e Shqipron Brahimit në minutën e shtatë. Megjithatë, pejanët arritën ta kthejnë epërsinë në minutën e 16, me golin e Jeton Rukovcit, që në fund doli të jetë edhe goli i fitores, pasi në vazhdim arritën të mbrohen mirë, me gjithë presionin e vazhdueshëm të Feniksit. Portieri më i mirë u shpall Arbnor Krasniqi i Besës. Golashënuesi më i mirë ishte Agon Ramadani i Feniksit, derisa lojtari më i mirë i turneut u shpall Agon Rexhaj, kapiten i Besës.

### Salahi merr dhuratë të çmuar në Mekë

Për të gjithë myslimanët Meka zë një vend të rëndësishëm në zemrat e tyre. Ajo ishte pika ku të gjithë besimtarët myslimanë drejtohen kur falen dhe pa dyshim se zë një vend të madh dhe në jetën e tyre. Lojtari i Liverpoolit, Mohamed Salah, është një besimtar mysliman shumë i përkushtuar në praktikën e Islamit, me namazet, agjërimin, leximin e "Kuranit" madje dhe atë që quhet Haxh.
Zëvendëspresidenti i komunës në Mekë, Fahd Al-Rowky, ka thënë se planifikon t'i dhurojë futbollistit egjiptian, Mohamed Salahut, tokë në Mekë, në shenjë të urimit për fitimin e çmimit "Lojtari më i Mirë i Vitit në Premierligë". "Ekzistojnë disa opsione sa i përket dhënies së një cope tokë Salahut. Kjo do të vendoset nga kapiteni Mohamed Salah dhe sistemi saudit. Nëse sistemi saudit lejon që toka në Mekë të jetë në pronësi të Salahut, atëherë atij do t'ia dhurojmë një copë tokë në Mekën e shenjtë, pranë xhamisë Al-Haram. Opsioni tjetër do të jetë ta ndërtojmë një xhami në këtë tokë në emër të tij. Dhe opsioni i tretë është ta shesim tokën dhe t'ia japim paratë Salahut, nëse ai pranon", ka shpjeguar Al-Rowky. Rowky ka shprehur mirënjohje për Salahun për sjelljet e tij që meritojnë lëvdata, duke e cilësuar si dërgues të mrekullueshëm të islamit në Britani të Madhe.

### Klopp: Ende nuk jemi kualifikuar

Trajneri Jurgen Klopp nuk beson se Liverpooli e ka siguruar finalen e Ligës së Kampionëve, pas fitores ndaj Romës me rezultat 5-2. Trajneri gjerman e ka marrë si shembull atë që i ndodhi Barcelonës, e cila e kishte fituar ndeshjen e parë në "Camp Nou" me rezultat 4-1, por që në ndeshjen kthyese u mposht në "Olimpico" me rezultat 3-0. "Ne nuk jemi Barcelona, nuk kemi fituar asgjë. Do të shkojmë atje për ta siguruar kualifikimin në finale. A pres një Romë më ndryshe në ndeshjen e kthimit? Po", Ka deklaruar Klopp.

### Di Francesco beson në kualifikim

Trajneri i Romës, Eusebiu Di Francesco, e pranon se skuadra gaboi shumë, por u kënaqet dy golave të shënuar në 10 minutat e fundit, që mbajnë gjallë shpresat e Romës. Italianët u mposhtën nga Liverpooli (5-2), në gjysmëfinalen e parë të Ligës së Kampionëve. "Është e vërtetë që luajtëm shumë dobët dhe humbëm shumë duele me kundërshtarët. Gjithsesi, dy golat e fundit na dhanë shpresë jo vetëm për rezultatin, por edhe për të besuar se nëse luajmë ashtu si në 10 minutat e fundit, mund t'ia dalim të kualifikohemi", ka thënë Di Francesco. "Nuk do të jetë një ndeshje e ngjashme me atë ndaj Barcelonës, pasi janë dy skuadra të ndryshme për mënyrën e lojës. Gjithsesi ne duhet të besojmë për kualifikimin, pasi futbolli është një sport që shpërblen ata që u shkojnë gjërave deri në fund dhe nuk dorëzohen", ka deklaruar trajneri i Romës.

Këtë tregim i'a kushtoj nënës time Zahide (10.11.1931 - 26.04.2017), me rastin e një vjetorit të vdekjes

# Automatiku i bartur nga nëna Z. i shërbeu UÇK-së të ZOK-ut



Gani SHALA

Krismat e armëve të ushtrisë fashiste serbe dhe të lehurat e qenve të fshatit T, dëgjoheshin jo larg shtëpisë së nënës Z. Këto krisma e kishin zgjuar nga gjumi nënën, e cila së pari, si gjithherë, i kishte përsëritur duatë e mëngjesit, ishte lutur për fëmijët e saj, për nipat e mbesat, të cilët flinin qetësisht, pa ditur çka do të sjell dita e cila sapo agonte. Ata ëndërronin për një të ardhme më të mirë, për lirinë, që ndoshta ende nuk mund ta kuptonin, por e cila patjetër do të vijë një ditë. Njëri nga fëmijët bëri një gjysmë rrotullimi duke i mbetur shpatullat e zbuluara. Nëna Z. ia mbuloj trupin e zbuluar, e puthi në ballë dhe e pëshpëriti një lutje, siç dinë gjyshet, për nipat dhe mbesat e tyre.

Në një moment, nënës, iu kujtua fëmijëria e saj, atëherë kur gjyshja nga fshati D. e kishte humbur djalin e saj në moshën më të re. Edhe atëherë ishin ushtarët e pushtuesit të trojeve tona, prindërit e këtyre ushtarëve që ndodheshin edhe tani jo shumë larg shtëpisë së nënës, që ia kishin marrë djalin, dhe që nga ajo ditë e deri sot nuk i dihet varri. Përflitej se varri i tij është në fshatin Kuzhincë, një fshat i banuar me serb.

Edhe nëna Z. sa herë e kujtonte këtë ngjarje, e përmendte këtë fshat.

Asaj i kujtohet, po ashtu, se sa ishte e re gjyshja e saj, në fshatin D, e ruante, sipas traditës, me fanatizëm një kilogram sheqer, që e kishte blerë për djalin e saj në rast fejese. Çdo mbrëmje merrte kilogramin me sheqer dhe i lutej zotit t`ia kthej djalin në shtëpi, të bënte një dasmë dhe ta shpenzonte sheqerin e ruajtur prej vitesh për dasmorët e thirrur. Por kot, vitet kalonin e djali i saj nuk kthehej.

Gjyshja, pas shumë vitesh pritje, pasi kishte humbur shpresat se djali i saj do të kthehej i gjallë, filloi t'i lutej zotit, së paku, t`ia gjente varrin e pastaj eshtrat e tij t'i sjell në varrezat e fshatit.

Mos gjetja e varrit, gjyshen nuk e lente rehat, i dhembte shpirti e thoshte se nuk do të mund t'i mbyll sytë pa e gjetur djalin, gjallë a vdekur.

Njëherë ajo iu kishte lutur babait tim, që të dilnin, të dy, së bashku ta kërkonin varrin e djalit, të humbur para shumë vitesh, pa e ditur se ku. Dhe kështu, në një mëngjes vjeshte, gjyshja dhe babai, edhe pse nuk dinin se nga të shkonin, ishin nisur. Ajo përmendte vetëm një emër të një fshati, pa e ditur vendndodhjen e tij. Disa thoshin se ky fshat ndodhet diku larg në Malësinë e Dardanës, disa të tjerë thoshin se ndodhej afër Prishtinës, pra, askush nuk e dinte vendndodhjen e saktë të këtij fshati.

Thanë do të pyesim kalimtarët e rastit për fshatin Kuzhincë. Me vete kishin marrë ushqim. Pyetnin kalimtarët, por të gjithë i rrudhnin krahët, nuk dinin vendndodhjen e këtij fshati. Po gjyshja dhe babai vazhdonin kërkimin. Ndaleshin në varrezat e çdo fshati, i pyetnin fshatarët, a mos vallë dinin për një djalë të ri të vrarë nga ushtria serbe. Varre të shqiptarëve të vrarë kishte

Gjyshja nga fshati D. dhe babai im vazhdonin rrugën nga fshati në fshat nga varreza në varrezë, por kot, nuk kishin kurrfarë informate për djalin e saj. Pas disa ditë kërkimi vendosën të kthehen në shtëpi. Rrugës për në shtëpi, gjyshja e uritur dhe e lodhur, kishte hasur në një pengesë dhe ishte rrëzuar. Ajo i kishte thyer dhëmbët, por nuk kishte ndier kurrfarë dhimbje, sepse dhimbja për djalin ishte shumëfish më e madhe.

I kishin varrosur pa asnjë mbishkrim, pa asnjë informatë. Ishte një ditë e ftohët kur babai dhe gjyshja u kthyen në shtëpi. Ne, fëmijët iu afruam gjyshes dhe e përqafuam të gjithë së bashku, për t`ia larguar sadopak dhimbjen që kishte në shpirt. I afruam ujë dhe bukë po gjyshja nuk hante, vetëm përsëriste fjalë që edhe sot më kujtohen:

**"S`mundi nëna me bë gjë më tepër, biri i nënës, por jam e lumtur që i humba dhëmbët për Ty".**

Disa krisma të njëpasnjëshme e larguan nënën Z. nga ai kujtim i tmerrshëm, e mbuloi fytyrën me duar duke thënë disa dua që nëna i përsëriste çdoherë kur i epej mundësia.

E largoi batanijen nga dritarja që vihej për çdo mbrëmje, që dritat të mos duken nga ushtria serbe. Rrezet e diellit i përqafuan nipat dhe mbesat, sikur donin t'i premtonin nënës se, do t'i ruanin të mos i ndodhin gjë këtyre krijesave të pafajshme.

Me frikën e ditës së re, ajo zbriti ngadalë shkallëve, hyri në dhomë për ta parë djalin e saj të madh, i cili veç kishte vite që ishte në shërbim të UÇK-së, për të marr një mirëmëngjesi nga ai, po dhoma ishte e zbrazët.

Nëna ndjeu një dhimbje të madhe në shpirt. U ul në ulësen afër dritartës, ku dukeshin lëvizjet e asaj ushtrie të mallkuar që kishte ardhur në tokën e nënës Z. në tokën që ia kishin lënë të parët e saj.

Djalit të madh në mbrëmje i kishte ardhur porosia se duhej patjetër ta kryente detyrën, të cilën ia kishin ngarkuar. Ai që me natë ishte ngritur, pa i treguar askujt, për ta kryer porosinë. Pas marrjes së detyrës, në një vend ku duhej të kalonte, rruga ishte bllokuar nga forcat ushtarako policore serbe. Situata ishte e rënduar, por djali duhej të ndërmerrte diçka. Automatikun që e kishte me vete, duhet për momentin ta lente diku, se vetëm kështu do të mund t'i shpëtonte kapjes nga ushtria serbe, të cilët kishin vendosur një rrethim të hekurt e bënin kontroll edhe të zogjve që fluturonin. Shpejt iu kujtua se aty afër është një shtëpi shqiptare. Edhe pse ishte e rrethuar me shtëpi serbe, vendori të trokas. Pasi hyri në oborr dhe pasi u përshëndet me të zotin e shtëpisë, i hodhi një shikim oborrit duke u ndalur te koteci. Mendoj, aty duhet ta fsheh automatikun derisa ta kryej detyrën e ngarkuar. E mbuloi me tjegulla që rastësisht kishin qëlluar aty dhe iku.

Derisa nënës Z. i silleshin mendime të frikshme në kokë për djalin e saj, u dëgjuan të trokiturat në dyert e oborrit. I theri zemra aq fort, sa nuk u rrëzua. Mblodhi veten dhe doli në oborr duke pyetur veten. Vallë kush do të jetë në këtë kohë të pakohë? Mos janë ata të mallkuar që sillen vërdallë nëpër fshat dhe vijnë ta kërkojnë djalin?! Hapi derën dhe përpara i doli një mesoburrë. Pasi u përshëndet me nënën, ai i tregoi në mënyrë të hollësishme për djalin e saj për hallin që e kishte sjell deri aty. Mes tjerash i tha se, djali i saj ishte i ngarkuar me detyrë, po rrugës djali ishte informuar, se rruga për ku ishte nisur, është e bllokuar nga ushtria serbe. Derisa detyra duhej të kryhej patjetër, ai armën që barte, e ka lënë në shtëpinë time.

Nëna e kuptoj shqetësimin e të sapo ardhurit dhe me një vendosmëri të madhe iu zotua se, sa më shpejt të jetë e mundur, do të vij ajo vetë ta marr e ta sillte në shtëpi. I sapoardhuri mbet shumë i kënaqur me vendimin e nënës, dhe u largua pa bërë zë për në qytetin ku ai banonte.

Nëna Z. kishte marrë një vendim shumë të vështirë, po duhej kryer pa marr parasysh pasojat që do t`i dilnin. Ashtu e shqetësuar u kthye në dhomën e saj dhe pa humbur kohë, veshi rrobat e saj, që gjithherë i vishte kur merrte ndonjë rrugë, zbriti në dhomën tjetër, ku fëmijët e djalit ishin duke qëndruar. Ata kur pan fytyrën e gjyshes e rrethuan dhe filluan ta pyesnin, se çka ishte aq shumë e shqetësuar?

Fëmijët kur dëgjuan rrëfimin e gjyshes mbetën të shtangur, por nuk u hamendën, donin t'i ndihmonin. Njëri nga fëmijët u shqetësua më tepër se të tjerët, sepse ishte i vetmi që e dinte historikun e automatikut.

Iu kujtua xhaxhai i cili kishte blerë këtë automatik për nevojat e një celule që i takonte edhe ai vetë, të cilin disa vite e kishin mbajtur shokët e tij në qytet, iu kujtuan edhe dy shokët që njihte shumë mirë, iu kujtua edhe e trokitura dhe zëri i I., shokut të xhaxhait që jetonte në qytetin e Gj. dhe xhaxhai që doli e mori trastën dhe shakat e tyre derisa hynë brenda në dhomë. kujtua në moment edhe rrëfimi i shokut të xhaxhait pasi e kishte sjell armën.

"Gjendja në qytet gjithnjë e më tepër po vjen duke u vështirësuar. Janë duke u bërë kontrolle të shpeshta të policisë serbe në qytet. Armën që po e mbajmë, e shpesh e kemi bartë edhe në qytet, tani është rrezik që ta humbim. Pas vëzhgimeve që i kemi bërë e jemi duke i bërë unë dhe T. presim se do të na arrestojnë policia, dhe gjatë arrestimit mund të ndodhë që të na gjendet arma, e cila është shumë e nevojshme për luftën e cila së shpejti do të jemi të detyruar ta fillojmë në vetëmbrojtje. Ngaqë nuk është momenti ende të fillohet luftë e hapur me policët serbë, e mund ta humbin një armë shumë të vlefshme na u dashtë të mendojmë se si do t'ia bëjmë me automatikun. Me shokun T. e analizuam gjerë e gjatë se ku është më mirë të qëndrojë automatiku i celulës deri sa të na duhet për veprim. Erdhëm në përfundim, se, më i sigurt është të jetë në fshatin T. Këtë mendim e ka aprovuar më parë edhe shoku S.

Pas këtij vendimi, futa automatikun në një trastë të thjeshtë, e mbulova me molla të blera në treg, kinse për fëmijët, dhe dola në stacionin e autobusëve që nuk ishte edhe aq larg. Në stacion kishte lëvizje të pakta; ndonjë njeri aty këtu, edhe ata ishin më tepër qytetarë serbë. Gjeta autobusin që vinte deri në qytetin e K. Në autobus ulem diku kah mesi pranë dritares. Trastën e vendosa pak më larg në sirtarët e tavanit të autobusit duke u munduar që të largojë dyshimin e shoferit dhe të udhëtarëve tjerë, që shumica ishin serb. Shqiptarët në këtë kohë lëviznin shumë pak, lëviznin vetëm në raste të domosdoshme.

Unë duke e ditur se autobusi qarkullon rrugës kryesore, ashtu siç kishte qenë gjithmonë, hipa në të, por pas disa minutash mori drejtim krejt tjetër, duke u futur, kështu edhe nëpër fshatrat e banuara vetëm me serbë: R. e Ko. gjë që më parë kjo nuk kishte ndodhur.

Në fillim mendova se më paska hetuar UDB-ja dhe fillova të shqetësohem, megjithatë më duhej ta ruaja gjakftohtësinë, duke ia lëshuar sytë herë pas hera trastës ku e kisha vendosur. Ndalesat e autobusit në fshatrat serbe, u bënë vetëm për të zbritur udhëtarët, edhe pse prisja që në çdo moment të hynte dikush nga ato hijet e zeza. Fatmirësisht kjo nuk ndodhi. Posa doli autobusi në rrugën kryesore, mora frymë më lirisht, jo pse frikësohesha për vete, po mendoja për pasojat që do t'i kishte familja ime. Dhe kur autobusi u ndal në fshatin tuaj, T. mora trastën, zbrita ngadalë, dhe , sigurisht mora frymë lirisht. Dhe ja erdha tek ju së bashku me "shokun tim". Njërit prej fëmijëve të djalit, kjo ngjarje i doli përpara si një episod filmi

Këtë automatik që duhet të shkonte ta merrte gjyshja, e kishte pastruar shumë herë. Në moment iu dhimbs pa masë. Nuk mund të rrinte duarkryq, përkundër rrezikut, duhej të vepronte edhe ai, nuk mund ta lente gjyshen vet.

Mori veturën, i bëri gjyshes me shenjë që të hynte brenda. Ajo e kundërshtoi, sepse e dinte rrezikun dhe nuk dëshironte që të rrezikohej, por vendosmëria e tij nuk e la gjyshen të mendohej gjatë. Ai duke ditur se qarkullimi përgjatë rrugës kryesore është rrezik, për shkak të lëvizjes së ushtrisë serbe, vendosi që të shkonin në një rrugë dytësore. Gjyshja gjatë gjithë rrugës mendonte se si ta bind që të kthehet apo të ndalojë diku më afër, në mënyrë që ai të mos rrezikohej. Në një moment iu duk se gjeti një zgjidhje. Iu lut që me veturë ta dërgonte vetëm deri në fshatin K., i cili ishte edhe fshati i lindjes së nënës Z. e pastaj nga aty do ta vazhdonte rrugën në këmbë deri në shtëpinë ku djali i saj e kishte lënë automatikun.

**- Kthehu në shtëpi, se tani unë shkoj në këmbë, se tani edhe nuk është larg.**

**- Iu bind fjalëve të gjyshes me vështirësi, duke i thënë asaj se do të pres këtu, në këtë vend, deri sa ajo të kthehet.**

Vapës së madhe të asaj dite dhe diellit kërcëllues, nëna Z. nuk donte t`ia dinte. Mendja i rrite vetëm te fjala që ia kishte dhënë të sapoardhurit:

**- Se do të vijë më shpejt të jetë e mundur.**

Edhe pse në moshë, ajo ecte me hapa të shpejt, po edhe rrugët ishin të njohura për nënën Z, sepse, si fëmijë kishte ecur nëpër këto rrugë. Sa e sa herë kishte kaluar me bagëti. Pasi kaloi rrugët arriti tek vendi ku i kishte sjell me qindra herë bagëtinë për pushimin e drekës. Këto rrugica, vendi i ruajtjes së bagëtisë, për një moment e larguan nga qëllimi i këtij udhëtimi. Dhe, pa e vërejtur rrugën e mbetur, arriti tek shtëpia. Pa trokitur hapi portën, dhe hyri në oborr, ku e priste plaka e shtëpisë, e cila ishte moshatare me nënën Z. Shpejt e shpejt, të shqetësuara, ndërruan disa fjalë të zakonshme të takimit të rastit. Plaka i solli ujë dhe bukë sipas traditës, po nëna Z. nga shqetësimi, lodhja e rruga e gjatë, piu vetëm ujë dhe u ulë në shkallët e shtëpisë. Nuk kishte kohë për të humbur, duhej sa më shpejt të nisej për në shtëpi.

Pasi shikuan rreth e rrotull shtëpisë, e cila ishte e rrethuar me shtëpi serbe, dhe pasi u bindën se askush nuk po i vëzhgonte, shkuan te vendi ku ishte automatiku. E mori nëna Z. në duar. Ishte hera e parë që kishte në dorë armën, edhe pse e kishte parë disa herë prej së largu, kur djemtë e pastronin. Automatiku ishte i ftohtë dhe kishte një peshë që nëna s'e kishte menduar. Iu duk i rëndë, ndoshta për shkak të moshës.

Biseduan me plakën e shtëpisë se si ta maskonin që të mos vërehej gjatë rrugës. Vendosën që armën ta mbështjellin me përparësen që e kishte dhuratë nga shoku i djalit, T., dhe ta vendos në shpinë. Përveç përparëses nëna ishte e mbuluar mirë, bile kishte marrë edhe tesha tjera shtesë, se e kishte menduar këtë me kohë.

Pasi u strehuan në një vend të përshtatshëm, ku s'shihej nga shtëpitë serbe, nëna Z. e mbështolli mirë e mirë dhe e vendosi mbi shpinë duke e lidhur për trupi me litar në mënyrë që të ishte sa më stabile dhe të ecte më lirisht rrugës për në shtëpi.

Deri sa dy plakat merreshin me rregullimin e automatikut në anën tjetër të murit dëgjoheshin këngë dhe krisma armësh, bëhej festë nga ushtria e policia serbe. Dy plakat nuk donin t`ia dinin. Ato vazhdonin punën e tyre për ta maskuar sa më mirë armën.

Për të vërtetuar se arma ishte përforcuar mirë e nuk vërehej, nëna Z. eci disa hapa para e prapa. Pasi u bindën se automatiku në shpinën e nënës Z. ishte mbuluar mirë, ajo piu një gotë ujë dhe pa humbur kohë të dyja dolën nga oborri i shtëpisë, duke marr rrugën e kthimit për në shtëpi.

Ecnin që të dyja duke biseduar e duke pasur kujdes që mos të bien në sy edhe të atyre që ishin bërë një me ushtrinë e policinë serbe. Pas disa kilometrash nëna Z. u përshëndet



Zahide Shala

me plakën e shtëpisë duke i kërkuar falje për atë që i kishte ndodhë kësaj shtëpie.

Ashtu e vetmuar vazhdoi rrugën. Përkundër peshës së madhe që mbante në shpinë, tash nëna Z. ishte më e lehtësuar, sepse e kishte kryer me sukses premtimin e dhënë. Ajo gjithashtu thoshte me vete, se tani le të ndodhë çka të ndodhë, unë jam e vetme dhe vetëm unë do të përgjigjem për veprimet e mia.

Cicërimat e zogjve dhe gurgullimat e lumit e bashkëshoqëronin nënën dhe sikur i thoshin:

- Moj nënë ti nuk je e vetme, ne do të bëjmë shoqëri dhe s`lejojmë te të ndodhë ndonjë e keqe. Na jep edhe ne një pjesë të barrës që mban mbi supe.

Forma gjarpërore e rrugës dhe e lumit prishej vetëm pak kilometra në hyrje të fshatit K. Aty filluan të duken edhe lëvizjet e pakta të fshatarëve të cilët vëreheshin në fytyrë se ishin shumë të brengosur për situatën, ngase në çdo moment mund t'i ndodhte fshatit ndonjë e papritur e frikshme. I frikoheshin ndonjë masakre, sikurse ndodhte në pjesët tjera të Kosovës.

Zhurma e fëmijëve, që ishte mësuar ta dëgjonte nëna Z., ishte zhdukur, e kishte ngrënë kuçedra serbe. Në ara e fusha nuk dukej njeri. I gjithë fshati jetonte me friken e masakrës nga ushtria dhe paraushtarakët serbë. Kjo heshtje varri ishte më e rënd se automatiku që mbante.

Ashtu e lodhur, sa nga pesha, sa nga rruga, sa nga qetësia në fshat, nëna vazhdoi rrugën për te vendtakimi. Kaloj urën e cila ndodhej vetëm disa metra larg vendit ku e priste njëri nga fëmijët e djalit, dhe, ashtu të heshtur, pa ndërruar asnjë fjalë vazhduan rrugën për në fshatin T.

Edhe pse nëna Z. ishte tash në veturë, pesha e merakut ishte shumëfish më me madhe se sa kur ishte vetëm me peshën e automatikut. Ashtu në heshtje i lutej Zotit ti shpëtonte nga ky rrezik.

Vetura ecte me shpejtësi normale për të mos rënë në sy të ushtrisë dhe policisë serbe, pozicionet e të cilëve nuk ndodheshin edhe aq larg fshatit T.

Pas disa minutash vetura hyri në oborrin e shtëpisë. Pa bërë zhurmën më të vogël, nëna Z. zbriti nga vetura dhe ashtu e kujdesur, së bashku e vendosën automatikun në një vend të sigurt.

Nëna Z. mori frymë lirisht, jo nga pesha e automatikut, por nga përmbushja me sukses e fjalës që i kishte dhënë burrit që kishte hyrë në shtëpi dhe i ishte lutur për largimin e armës, nga shtëpia e tij.

Fjala besë për nënën, edhe pse në moshë , kishte kuptim shumë të madh, peshonte më shumë se jeta e saj. Ishte tepër e lumtur që fjalën e dhënë e dërgoi në vend, e bëri realitet.

Shpëtimi i jetës së djalit dhe njërit nga fëmijët e tij, sikurse edhe shpëtimi i armës, për nënën Z., ishin vetë jeta e saj. Automatiku i bartur nga nëna i shërbeu UÇK-së të ZOK-ut, ndërsa nëna Z. vazhdoi jetën e lumtur së bashku me djemtë, vajzën dhe nipat e mbesat e saj.

CN.nr.247/2017

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil**, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarin Fatmir Aliu, me sekretaren juridike Ibadete Hasani dhe përkthyesen Xhevide Selmani, në çështjen jokontestimore të propozuesit **Radivoje (Milorad) Radisavljeviq** nga Beogradi rr. "Vëllezërit Rankoviq" nr.90 në Serbi, për shpalljen e personit të zhdukur dhe atë babain e tij Milorad Radisavljeviq, e ish me vendbanim në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, pas mbajtjes së seancës jopublike, në prani të propozuesit me dt.08.02.2018, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se personi Milorad Radisavljeviq, i lindur me dt.04.01.1935 nga babai Milan dhe nëna Radinka në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, e ish me vendbanim e fundit në fsh.Revuç, **ËSHTË ZHDUKUR në muajin Prill të vitit 1999 në fsh.Revuç, Komuna e Poduevës.**

**A r s y e t i m**

Propozuesi Radivoje Radisavljeviq në propozimin e ushtruar pranë kësaj gjykate me datë 14.08.2017, i ka propozuar gjykatës që të shpallë personin e zhdukur Milorad Radisavljeviq, i lindur me dt.04.01.1935 nga babai Milan dhe nëna Radinka në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, e ish me vendbanim në fsh.Revuç, e është zhdukur në muajin Prill të vitit 1999 në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, lidhur me propozimin në seancën e dt.08.02.2018 ka deklaruar: Unë njohurin për zhdukjen e babai tim Milorad Radisavljeviq e kam marr në vitin 1999 gjatë luftës dhe atë në muajin Prill e i cili ka qëndruar në fsh.Revuç të Komunës së Podujevës e njohurin më të saktë për të njëjtin se nuk po gjendet e kam marr pas 10 ditësh të po muajit prill sa unë isha në Beograd. Unë e kam lajmëruar edhe Kryqin e kuq ndërkombëtar për çka për të njëjtin kam paraqitë edhe kërkesë me dt.25.10.1999 për kërkim të të njëjtit të babai tim Miloradit i cili ka lindur me 01.04.1935 në fsh.Revuç Komuna e Podujevës, mirëpo nga ajo kohë unë kurrfarë informacioni nuk kam për të njëjtin andaj unë kam parashtruar kërkesë për regjistrimin personit të zhdukur si t vdekur me dt.14.08.2017 me të cilën kam kërkuar që të regjistrohet baba i im zhdukur në librat e personave për të zhdukur andaj kërkoi nga gjykata që të aprovoi propozimin tim që të kem mundësi që të njëjti ta regjistroj në librat për të zhdukur.

Dëshmitari Milja (Jevtimije) Antonjeviq nga Leposaviqi rr. "24 Nëntor" nr.6, lidhur me propozimin e propozuesit Radivoje Radisavljeviq në seancën e dt.08.02.2018 ka deklaruar: Unë me propozuesin jam kushëri dhe familjarisht jemi të afërm dhe edhe unë e kam marrë njohurin për zhdukjen e Miloradit diku 10 ditë pasi që është lajmëruar i njëjti se është i zhdukur, këtë informacion e kam marr nga djali i të zhdukur Radivoje Radisavljeviq dhe nga ajo kohë për të njëjtin asgjë nuk dimë. Momenti i zhdukjes ka qenë diku në vitin 1999 në fshatin Revuç dhe tjetër për këtë nuk kam çka të shtoi.

Dëshmitari Kersto (Borisav) Subotiq nga Leposaviqi rr. "24 Nëntor" pn., lidhur me propozimin e propozuesit Radivoje Radisavljeviq në seancën e dt.08.02.2018 ka deklaruar: Unë jetoj nga viti 1999 në Leposaviq dhe me Milja Antonjeviq unë aty jam takuar dhe përmes tij e kam njohur edhe Radivoje Radisavljeviq dhe nga aty e kam marrë njohurin se Radivojit i është zhdukur prindi në vitin 1999 në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës dhe nga ajo kohë për të njëjtin as familja e tija apo dikush nga familjaret e tij nuk ka njohur për të njëjtin. Tjetër lidhur me këtë nuk kam çka të shtoi.

Gjykata në procedurën e provave administroi këto prova: U lexua kërkesa e bërë nga ana e gjykatës QPS-së me dt.21.11.2017, u lexua anamneza e QPS-së me numër protokolli 2372 e dt.04.12.2017, u lexua shpallja e kësaj gjykate me dt.29.12.2017, si që ceket më lartë e cila iu ka drejtua institucioneve kompetente dhe është publikuar në gazetën me dt.20.01.2018, u lexua ekstrakti i të lindurve me nr. vijues 176 i dt.20.08.1987 në emër të Radivoje Radisavljeviq, u lexua dokumenti i dt.07.09.2001 të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar me të cilin vërtetohet se është bërë kërkesa me dt.25.10.1999 për kërkim të zhdukurit Milorad Milan Radisavljeviq, si dhe u shikuan fotokopjet e letërnjoftimit të propozuesit dhe dëshmitarëve.

